

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XV i botimit, nr. 172, Shkurt 2018

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

URIM I TRISHTË PËR 7-MARSIN!

Nga Lazër Kodra **2**
Shpirti iu pushoftë...
Ju që me 7 Mars hapët kapakët e derës së parë të shkollës shqipe!
Etalon i Parajsës qoftë shpirti Juaj! Jo më kot Shën Pjetri ua çeli portën e Saj. Nderim e perulje para veprave të Buzukut, Barletit, Budit, Bogdanit, Bardhit, Veqil-haxhit, Naimit, Çajupit, Asdrenit, De Radës, Pashko Vasës, Mjedës, Gurakuqit, Fishtes, Migjenit, Camajt, Pipës e shumë e shumë të tjerëve, që bënë të mundur mbijetesën e kësaj gjuhe Indevropiane në origjinë, dhe shumë Evropiane në vokacionin semantik në kohën e atëhershme. Një urim Drite edhe për ata mësues e mësuese, të cilët prehen në jetën e Amshueshme, të cilët kontribuan aq thjeshtë e devotshëm në përçimin e vlerave të kësaj gjuhe në të gjithë skajet e Shqipërisë, pa dallim feje, krahine, ideje, race, qyteti, fushe e malesh midis shkëmbinjëve. Atyre, që me thëngjill salvuan mbi mure shkronjat e Alfabetit Shqip!

GJERGJ KASTRIQTI, HEROI YNË KOMBETAR **5**

- FJALA E PAVDEKSHME PËR TË GJITHA GJENERATAT SHQIPTAR... -
nga Mejreme Gjocaj

Ja si është shprehur Gjergj Kastrioti:
"Jam në prag të varrit. Po ju lë një mbretëri me forca të afta për ta mbrojtur, por me një pasardhës të paaftë nga mosha për ta drejtuar. Megjithatë, në qoftë se në të ardhmen ju bëheni trima dhe të virtytshëm, ju mund të përballoni të gjitha sulmet e armiqve tuaj. Nuk është sipërfaqja e vendit ajo që bën një fron të respektueshëm, por aftësia e atij që ulet mbi të. Në qoftë se ju jeni i djallëzuar, shërbëtor i ministrave tuaj, dhe naiv i lajkave të oborrtarëve tuaj, atëherë asgjë nuk do të jetë më e lehtë sesa përmbysja nga maja më e lartë ku ju ndodhni. Duhet të jetë virtyti themel i fronit. Virtyti nuk është fantazi. Ndoshta do ju a thonë një ditë, por mos harroni se ai që do ju a thotë, është një tradhtar, një dinak, që për të mbretëruar në vendin tuaj, do ju sugjerojë maksima të rreme, të cilat herët a vonë do të shkaktojnë përmbysjen tuaj.



DOSJA E HAPUER HETIMORE E MARTIRIT GJELOSH LUSHI NGA SHOSHI!

AKT AKUZA NR 402. SHKODËR, ME 20.07.1945

Pas arrestimit Prokuroria Ushtarake e Rrethit Shkodër me Letër -rreshtimi nr 359, kundra Gjelosh Lushit, i biri i Lushit dhe i Soses, vjeç 32, nga Katundi Pepsuj, Shosh akuzohet si *Armik i Popullit* në bazë të Nenit Nr .1.të J... nr 21 datë 15.12.1944. **8**

"SUKSESI" I TURISTIT-HULUMTUES AUSTRIAK NË NJË FOTOEKSPOZITË TË MANIPULUAR

Në këta 27 vjet të turbullta të demokracisë kënetë, nëpër vendin tonë të quajtur "vendi i shqiponjave", kanë hyrë e kanë dalë lloj-lloj pelegrinësh, syfetesësh e kapuçinësh, të cilët kanë qenë tëpërkë me personazhet e "Emblemës së dikurshme" të shkrimtarit tonë I. Kadare.



Komedia Hyjnore Ferri, Kanga II **11**

AREALI KULTUROR I VERIUT në shekullin XVI-XIX **3**

nga Bardhyl Demiraj

Jo rrallë ndodh që një studiues të hasë vështirësi në përzgjedhjen e një titulli të përshtatshëm, kur mendon të mbyllë një monografi, sidomos aso rasash, kur është më se i ndërgjegjshëm që nuk mund të realizojë në plotësinë e vet atë dëshirë e qëllim që desh t'i vinte vetes mirëfilli. Vështirësi shtesë përcjell në këtë paplotësi vetë titulli i kësaj monografie ...

NDAHET NGA JETA PIKTORI I MIRËN JOHUR NDOC GURASHI **7**

"ANËTARI I NDERIT TË SHOQATËS ATDHETARE DUKAGJINI"

Përcillet për në banesën e fundit piktori dhe intelektual i njohur i Shkodrës Ndoc Gurashi. Ndoc Gurashin një nga emrat më të mëdhenj të artit figurativ shkodran e shqiptar mbylli sytë në moshën 95 vjeçare. I vlerësuar me shumë çmime e tituj, me ekspozita të hapura brenda dhe jashtë vendit, ai do të mbetet në memorien...

URIM I TRISHTË PËR 7-MARSIN!



Nga Lazër Kodra

Shpirti iu pushoftë në Paqe, Ju që me 7 Mars hapët kapakët e derës së parë të shkollës shqipe! Etalon i Parajsës qoftë shpirti Juaj! Jo më kot Shën Pjetri ua çeli portën e Saj. Nderim e perulje para veprave të Buzukut, Barletit, Budit, Bogdanit, Bardhit, Veq-

ilhaxhit, Naimit, Çajupit, Asdrenit, De Radës, Pashko Vasës, Mjedës, Gurakuqit, Fishtes, Migjenit, Camajt, Pipës e shumë e shumë të tjerëve, që bënë të mundur mbijetesën e kësaj gjuhe Indevropiane në origjinë, dhe shumë Evropiane në vokacionin semantik në kohën e atëhershme. Një urim Drite edhe për ata mësues e mësuese, të cilët prehen në jetën e Amshueshme, të cilët kontribuan aq thjeshtë e devotshëm në përçimin e vlerave të kësaj gjuhe në të gjithë skajet e Shqipërisë, pa dallim feje, krahine, ideje, race, qyteti, fushe e malesh midis shkëmbinjëve. Atyre, që me thëngjill salvuan mbi mure shkronjat e Alfabetit Shqip! Atyre, që mbi rrasa guri, brigjeve të prrojeve gdhenden me gurë - gri shenjat grafike të alfabetit tonë dhe i ligjëruan me foninë e tingujve hyjnorë korospondues. Atyre, që na mbeten në kujtesë përgjithmonë, pasi pa ta nuk do të ishim ata që jemi sot. Atyre, që i Pagëzuan me një emër të vetëm: MËSUES! Atyre, që ua mbajmë imazhin në sy, emrin në mendje e dashurinë në zemër! Urimet më të sinqerta për të gjitha ata mësues e mësuese, që i kushtuan djersë e mund profesionit të tyre. Atyre që ua zuri agu i mëngjesit sytë e çelur e mendjen e zgjuar. Atyre që për qindra netë të gjata patën për bashkëshort apo bashkëshorte në krevat, librin. U errëm me të e u zgjuan të përçafuar me të. Ç' dashuri!? - Dashuri për jetën, për diturinë, për të ardhmen, për profesionin, për njerëzit, për Atdheun e tyre! Mos vdektë kjo dashuri e venitur! Respekt e mirënjohje për të gjithë ata e ato mesuese, që edhe sot e kësaj dite, meritojnë të veshin petkun e mësuesit. Për ata që e kanë kthyer profesionin në mision. Përpiqen. Djersitin. Dhurojnë nga vetja e tyre, më të mirën, më njerëzoren, më fisniken, më të vlefshmen: DITURINË! Përveç 7- Marsit, atyre u uroj edhe qendresën! E di që nuk është e lehtë. Edhe pse bri vetes mund të keshë një injorantë apo injorante: QENDRO!

Edhe pse bri vetes mund të keshë të shitur e të blerë si specat në treg, mediokër të pashoq, përsëri: QENDRO!

Edhe pse bri vetes mund të keshë prej atyre që arsimin nuk e njohin për profesion, lëre pastaj për mision, përsëri: QENDRO!

Ata, bashkë me ata "lartësorët!", e shohin arsimin si strehë për njerëzit e ryshfetit, kostumografisë politike,



Banorë dhe nxënës të fshatit Theth, pranë shkollës së sapohapur. Në qendër Atë Marjan Prela. Foto e vitit 1921



fallsitetit të diplomave, kushëririt, të djalit tezes, mikut e deri tek lidhjet e birës së drejt! Atyre u uroj: Mos paçi kurrë në jetë fate të dhuruara nga Zoti! Ndërsa në jetën e përtejme u dashurofshi me epshin e shpirtit të Rosinantit të Don Kishotit! Hise dheu nuk do të keni për të mbuluar turpin në ditën e ikjes suaj. Por, Ti mik e mike e imja përsëri: QENDRO!

Qendro, sepse je mësues! Qendro, sepse misioni yt nuk mund të njolloset nga tipa të tillë që i ke përkrah. Sepse mendja jote nuk mund të errësohet nga leshelitë e kokëdaulleve.

Qendro, sepse ata nuk janë në të vertetë! Pavarsisht se mendojnë sikur janë, ekzistojnë vetëm si qenie të rëndomta pa statusin e vetëdijes apo ndergjegjes. Janë, thjeshtë vetëm hije ... hije të zeza, shumë të zeza! Kandari i tyre, fatëkeqësisht, nuk e peshon

turpin, peshon vetëm materien. Sa për ideale apo virtyte shtrydhin sisat e "fundit të bishtit të kavallit"!

Ti, mik e mikja ime nuk je nga ata. Ti je MËSUES! Ke sytë, fytyrën, mendjen, zemrën, shpirtin, dëshirën, pasionin, përkushtimin në sintoni të plotë me misionin që i ke vënë vetes. Ti duhet të qendrosh, sepse para teje çelen çdo ditë brazda jete për dikë. E ky 'dikush' dje ishte ti vetë, sot është 'dikush' tjetër e nesër do të jetë një tjetër 'dikush'! Unë e di, se ti nuk e vret jetën e të tjerëve, që në fillimet e saj, nuk vret kulturën e as arsimin e këtij vendi, këto dy institucione që vetëm injorantë nuk pranoin në 'kushtetutën e dikurshme të tyre'! Ti nuk bën pjesë në katastrofen e shpërfilljes. Ti nuk bën pjesë në pikiadën e rënies së lirë. Ti nuk bën pjesë në gjuhët e pa-marrëveshjes së "Kullës Babelit"! Po mos të ishin veshtersitë, nuk do të ekzistonte as qendresa.

Ato janë, si kurrë më parë, ndaj: QENDRO!

Ti je Heroi ose Heroina e kohës!

GËZUAR 7-MARSIN!- Por...BËJ QENDRESË!

Me rastin e 7 marsit, ditës së mësuesit

**MËSUESIT TIM TË PARË
MHILL LEKA**

Një mëngjes, në një 7 mars,
Telefoni bie, çoj receptorin,
Nga ana tjetër, një zë serbes,
Gëzuar, më thotë, 7 marsin,
Gjithë ëmbëlsi, dhe vazhdon,
Me shumë respekt, gëzuar,
Si mësues sot, o nxënësi im.
U zura në faj, nga që urimin,
Nuk ja dhashë unë më parë,
Me respekt të përshëndesja Mhillin,
Mësuesin tim të parë.

Ishte urimi i parë për atë 7 mars,
Që mësuesi im më bënte i pari,
Sytë lot të ngrohtë mu mbushën,
Atë mëngjes nga respekti dhe malli,
Për përkujdesjen dhe respektin që mësuesi im,
Nuk harroi të uronte gjithë mirësi
Me kujdesin e kahershëm dhe respekt,
Për profesionin dhe nxënësin e tij.

Luigj SHYTI



AREALI KULTUROR I VERIUT në shekullin XVI-XIX



nga Bardhyl Demiraj

Jo rrallë ndodh që një studiues të hasë vështirësi në përzgjedhjen e një titulli të përshtatshëm, kur mendon të mbyllë një monografi, sidomos aso rasash, kur është më se i ndërgjegjshëm që nuk mund të realizojë në plotësinë e vet atë dëshirë e qëllim që desh t'i vinte vetes mirëfilli. Vështirësi shtesë përcjell në këtë paplotësi vetë titulli i kësaj monografie që fokusohet në "Arealin Kulturor të Veriut në shek. XVI-XIX". Sigurisht që orientimi në dimensionet 'kohë' dhe 'hapësirë' nuk e lejon lexuesin patjetër të zbërthejë lehtë atë puzzle që bashkëmbart në kohën tonë koncepti 'areal kulturor' në shkencat e ndryshme shoqërore, në mos shumëkuptimësia deri në mosnjohje e vetë konceptit ase nocionit 'kulturë' në përgjithësi. Andaj jemi të detyruar paraprakisht me kumtuar në këto fjalë hyrëse do sqarime të rastit.

Asgjëmangut, në këtë monografi i përmbahemi një koncepti të diferencuar teorik të 'kulturës', duke u kufizuar këtu thjesht dhe vetëm në fushën formimit dhe të produktit intelektual që për periudhën në shqyrtim është përfutur ose ka pasur synim largvajtës mbarëshkrimin e tij në veri të hapësirës kulturore-etnike shqipfolëse. Parë nga kjo perspektivë, diferencimin që bëjmë brenda kësaj hapësire kompakte, pra duke u përqendruar në të ashtuquajturin 'Areal Kulturor të Veriut', e motivojnë për periudhën në fjalë sidomos aktivitetet e ndryshme intelektuale të institucioneve të kultit që ishin të pranishme në këtë zonë, siç është p.sh. rasti i angazhimit social të klerit katolik që vepronte atëbotë në Provincën administrative-kishtare të Arbënisë dhe në Arqipeshkëvinë e Shkupit.

Fokusimi ynë kryesisht në aktivitetet intelektuale të klerit katolik shqiptar e të huaj në këtë periudhë sendërton në domethënie e vet largvajtëse shi këtë koncept relativ të 'Arealit Kulturor të Veriut', meqë pikërisht këtu e përgjatë kësaj periudhe zë rrënjë e hedh shtat edhe ajo traditë e shkrimit shqip me alfabet latin, e cila ratifikohet në formën e vet përfundimtare me një kod të ri në Kongresin e Manastirit (1908), bash ashtu siç e shkruajmë dhe e ngjyrosim sot e gjithë ditën si alfabet të njësuar për gjithë hapësirën shqipfolëse. Dhe është fakt që një pjesë e konsiderueshme e këtyre aktiviteteve rezultojnë të zhvilluar e hedhur në letër atëbotë në gjuhën shqipe bash me këtë alfabet, madje duke e përdorur

atë edhe në komunikimin ndërinstitucional me Kurinë e Shenjtë (D/XXII) ase me organet e pushtetit vendor (D/XXIV).

Duke iu përmbajtur kësaj premise metodike lejohe mi së fundi të syzojmë si faktor integrues të këtij areali për periudhën në fjalë bash qytetin e Shkodrës si qendra kryesore urbane në gjysmën e dytë të shek. XIX, e cila falë angazhimit social të klerit katolik dhe të organeve të Protektoratit të Kultit vjen e shndërrohet natyrshëm në një vatër të parë dhe të mirëfilltë qoftë të formimit intelektual ashtu edhe të diskursit shkencor-albanologjik brenda hapësirës kompakte shqipfolëse. (A/IV)

Përmblodhëm kështu thukët përpos objektit edhe qëllimin dhe motivet që na nxitën t'i japim formë kësaj monografie, e cila rrok në vetvete një kolazh prej 29 studimesh, të organizuara në 28 krahë, përkatësisht në katër rubrika të veçanta. Ndër to, rubrika e parë ngërthen katër "vatra të formimit intelektual" me destinacion (edhe) Veriun katolik shqiptar (A/I-IV: Loreto, Romë, Fermo dhe Shkodër), ndërsa në rubrikën e dytë jemi fokusuar në do portretizime të asaj elite intelektuale që ka qenë aktive këtu gjatë periudhës në shqyrtim (B/V-XVII – "takime me elitën"). Jemi gjithsesi më se të ndërgjegjshëm sidomos për paplotësinë e kësaj rubrike, meqë jemi kufizuar në vetëm 13 emra personalitetesh që i takojnë pasurisë së patundshme të kulturës shqiptare, të cilëve, edhe në ato rase kur njihen, jemi përpjekur t'u plotësojmë portretin përkatës me të dhëna të reja bio-bibliografike që kemi mundur t'i qëmtojmë gjatë kërkimeve tona jo pa mund, durim dhe shpenzime të rastit në disa arkiva në Itali dhe Shqipëri (ASPF, ASSC, ACU, ARSI, AQSH). E që në këtë areal ka qenë aktiv një numër shumë e shumë herë më i madh syresh, lutemi që ky konstatim të vlerësohet thjesht dhe vetëm si argument shtesë, kur mëtojmë se një studiues i vetëm nuk është asses i gjendje të realizojë në plotësinë e nevojshme pasqyrimin e kësaj elite, madje edhe sikur t'i përkushtojë kësaj tematike gjithë jetën e tij aktive në profesion dhe atë të shëndetshme në pension.

Këtë rrethanë jemi rrekur ta bëjmë më se të dukshme dhe të prekshme në rubrikën e tretë, ku shpresojmë të sensibilizojmë sadopak lexuesin për 'mjerimin e madhështisë' që përjeton ndërkohë jeta intelektuale shqiptare (C/XVIII-XX – "kujtesa kolektive në 'tranzicion'"). Në këtë rubrikë vihet theksi fort tek ato pasoja tejet negative që vuan sot e

gjithë ditën formimi intelektual-albanologjik prej orientimit të dikurshëm ideologjik për krijimin e njeriut të ri intelektual me kujtesë historike-kolektive të shpëlarë (damnatio memoriae).

Sigurisht që kjo rubrikë do të ishte krejt e tepërt, në rast se në botimet e fundit të natyrës akademike (FESH, bl. I-III, Tiranë 2008/9) lexuesi i thjeshtë nuk do të përballej me procesin e dhunshëm të 'emilizimit' të enciklopedisë zyrtare (C/XVIII). Bëjmë fjalë këtu për atë dukuri sui generis në jetën intelektuale shqiptare pas kthesës historike demokratike (1991), një dukuri kjo që ngjiz në unison ndjesinë reale të 'kompleksit të inferioritetit' me atë irracionale të 'delirit të madhështisë' (laudatio funebris) që përjetonin dhe përjetojnë ende shumë e shumë (ish-)funksionarë intelektualë që drejtonin dikur institucione të ndryshme të formimit kulturor-intelektual dhe shkencor-universitar në vend.

Rubrika e fundit (D/XXI-XXVIII – "prurje të elitës") ngërthen si e tillë ndërhyrje të natyrës filologjike me kornizat paratekstuale përkatëse për tetë tekste si prurje thelbësore në trashëgiminë e kulturës së shkrimit shqip me alfabet latin përgjatë shek. XVII-XIX. Ndër to feksin edhe regjistrimet më të hershme të folklorit muzikor me notacionin përkatës (D/XXI). Këto tekste i nënshtrohen për të parën herë hulumtimit të mirëfilltë historik-kulturor, ekdotik dhe atij gjuhësor-normativ, bash sipas parametrave të filologjisë moderne. Një synim i dytë, por aspak dytësor, i autorit në këtë rubrikë është të ndjekë hap pas hapi prurjet në kulturën e shkrimit shqip me alfabet latin në 'Arealin Kulturor të Veriut', e cila arriti një pikë kulmore në gjysmën e dytë të shek. XIX, kur përjetojmë një normë të ngulitur të shqipes së shkruar mbi bazën e së folmes së Shkodrës si sendërtim i ndryshimit të paradigmes së vetë kësaj kulture, e cila i drejtohet tashmë formimit shkollor-intelektual të masës së thjeshtë qytetare (D/XXVI; D/XXVIII).

Është pikërisht kjo fazë e re zhvillimi në 'Arealin Kulturor të Veriut' që mbetet ende për t'u hulumtuar, krehur, sistematizuar e klasifikuar ashtu siç duhet. Veçse për këtë do hequr së pari mendje e dorë nga ai paragjykim sa i pavlerë aq edhe i pafan që i ka parë e i sheh këto prurje me syrin e njerkes, duke e cilësuar këtë trashëgimi në fund të shek. XIX si zhvillim regresiv drejt krahinorizmit ekstrem e kundërproduktiv, bash në një periudhë kur triumfonte Lëvizja kulturore-ideologjike e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Kush e shpërfill ose i anashkalon këtij mentaliteti antikombëtar, përjeton dhe përcjell ndryshe edhe atë kumt fatlum të At Anton Xanonit, kur shkruan në letër të bardhë menjëherë pas përfundimit të Kongresit të Manastirit: "Udhë mar i kioft alfabetit t'vieter e na rnoft i riu!" (LZJK 1909, nr. 3 37) Sigurisht që ky personalitet i kulturës intelektuale shqiptare e kishte fjalën për kodin e ri të shkrimit të shqipes me alfabet latin, siç e mësojmë dhe e përdorim të unifikuar sot e gjithë ditën. Parë nga kjo perspektivë, edhe ai koncept relativ që feks në titullin e kësaj monografie: "Areali Kulturor i Veriut në shek. XVI-XIX", fiton gjithnjë e më shumë tumirje dhe kuptim.

KTHIMI NË KRENARI, POR PA IDEOLOGJI!



Besi BEKTESHI

Sigurisht krenaria është një virtut që duhet çmuar dhe realizuar, por falsiteti në përdorimin e saj është një e keqe, që sjell pas mungesën e krenarisë reale kombëtare! Mes dy të këqijave të mëdha, ne patjetër duhet të fillojmë modelin e një krenarie racionale dhe të detyrueshme për një komb dhe sidomos shtet! Kaluam nga regjimi politik dhe sidomos ideologjik, i cili na imponoi një krenari pikërisht ideologjike dhe në çështjet kombëtare. Ai regjim patjetër që vlerësoi lartësi të mëdha kombëtare, por i shfrytëzoi në ideologjinë e tij aspak normale dhe për më tepër, irracionale dhe përjashtuese të fakteve e për më tepër transformimin dhe deformimin e tyre. Lavdia e armatosjes dhe stërvitjes komuniste, ishte falsiteti që “impresiononte” ato jashtë, por që kishte tragjizmin e urisë dhe groteskun këtu brenda! Njerëzit e aksioneve sigurisht ndërtonin socializmin dhe kishin krenarinë kolektivistike, por këtë gjë e bënin

në uri, mungesë dinjiteti personal dhe për më tepër, shpesh herë të shkuar dëm! Krenaria jonë historike e datave të mëdha si 28 nëntor, Lidhje e Prizrenit, 29 nëntor, 5 Maj, 7-8 mars e të tjera, e të tjera – mund të konsiderohen dhe sot moment i arritur, por absolutisht në shërbim të ideologjisë së famshme Marksiste Leniniste. Pse? Po sepse PPSH-ja, kështu i donte dhe krenaritë kombëtare dhe modelet e saj, me fill të kuq të ML-izmit! Edhe Gjergj Kastrioti i nderuar në regjim, edhe Fan Noli edhe Migjeni, apo Luigj Gurakuqi e vëllezërit Frashëri ose Ded Gjo Luli, apo Mehmet Shpendi bie fjala – ishin një krenari kombëtare dhe kjo nuk mohohet, por i promovonte kasta ideologjike dhe përdorshin për këtë kastë në çdo rast dhe pse ishte e drejtë të ngrije buste dhe lapidare! E kam fjalën - se krenaritë Ilirie dhe ato kulturore të trashëgimisë së tillë kështu trajtoheshin në një pjesë të madhe të rasteve – në ideologji! Muzika jonë kombëtare e trajtuar shumë mirë dhe bukur – trajtohej në shumë raste ideologjike dhe shërbim të partisë! Arti i pikturës dhe skulpturës po ashtu. Çdo reklamë dhe e dalë në mur - ishte krenari ideologjike e partisë. Çdo muzeum përpara krenarisë kombëtare kishte atë ideologjike – sepse sipas tyre ishte kjo ideologji që po e bënte të mundur këtë krenari! Padyshim një pjesë e madhe e brezit të sotëm nuk e kupton këtë gjë dhe as unë as të tjerë si unë nuk kemi se çfarë të bëjmë, por gjithsesi...! Duhet sqaruar se ishim “krenar”, por me një krenari të rrejshme dhe kur ishte e vërtetë! Ishte krenari ideologjike

dhe kaq! Mbas vetë rrëzimit të regjimit u instalua një “regjim” i ri i modelit anarki e komanduar. As që bëhet fjalë për demokraci, por patjetër një qasje e lirisë nga njerëzit e dalë nga ideologjia e dikurshme. Nuk dinin ndryshe – vetëm të imitonin, por në pikën e krenarisë nuk e imituan dot. Të zhveshur nga ideologjia, të liruar nga komplekset e saj, pa padronë të rreptë ideologjike si ato sipër dhe shoqëria filloi sulmin ndaj krenarisë kombëtare. Një sulm vet vrasës në dukje pa ideologji, por që kishte si bazë filozofike shkatërrimin e absolutisht çdo lloj gjëje në regjimin e dikurshëm. Nëqoftëse kishin pasur krenari dhe pse ideologjike në organizim për Kastriotin tashmë duhet të bënin sulm dhe ndaj figurës së tij dhe mundësisht duke përdorur dhe – religjionin. Sulmuan një dorë dhe Migjenin si antishqiptar. Ranë gjithë memorialet e ngritura në regjim, ose u shkatërruan ashpër. U shkatërrua muzealiteti nga goditjet që ju bënin krenarisë nën ideologji dhe pse shpesh herë ishin shumë të drejta. U lanë në hije artet e regjimit dikur, duke u shkatërruar kinematografia – e konsideruar ideologjike! U ngrit një “ideologjie e re” ose ajo e mungesës së krenarisë kombëtare dhe talljes me shumë dëshirë me të! U shkatërrua momenti krenar i heronjve dhe dëshmorëve – sepse “na paskan pasur krenari ideologjike nën regjim”. U shkatërruan kanalet dhe tokat, sepse ishin – krenari ideologjike! U fillua degradimi muzikor dhe moral në ekran dhe kudo – sepse na kishte ardhur në majë të hundës krenaria ideologjike e tillë në diktaturë! U

shkatërrua arsimit, sepse “kishte trashëgimi arsimit ideologjik” dhe po ashtu dhe shëndetësia sepse “ishte një krenari ideologjike?” Çfarë ndodhi? U ngrit një “dembelizëm dhe urrejtje patologjike anti kombëtare” e cila bëhej qëllimisht për të goditur demokracinë. Kështu u bë dhe me ekonominë dhe pronën. U shkatërrua gjithçka për të medemek - goditur krenarinë e socializmit ideologjik. Sot kemi ulur të gjithë krenaritë, sepse e çuam veten kaq keq, sa që dhe krenaria ideologjike e PPSH-së është pak “më e ndershme”. Çfarë na duhet mbas këtyre pothuaj 30 viteve marrëzi antikrenari kombëtare (edhe ajo në futboll është pak false) të rrëzuar. Padyshim largimin e imitimit të ideologjisë si dikur, e cila përjashtonte dhe monopolizonte. Ne kështu kemi bërë këto tre dekada. Dikur i bënte PPSH, sot i bëjnë këto marrëzi anti krenari – bijat e saj në pushtete e ndërruara shpesh.

Shoqëria jonë ka dëshirën e mirë të bashkohet me familjen Evropiane, por ajo krenarinë e ka te vlerat e saj pa ideologji dhe urdhër dhe pa imponim, por dhe pa imitimin në kundërshti të saj në liri. Krenaria e një kombi dhe shoqërie, është detyrim kombëtar pa ideologji dhe kundërvënja ndaj saj në mënyrë banditeske dhe politikë përfituese! Kjo na kërkohet sot dhe nuk duhet të jenë partitë që ta bëjnë – por shoqëria dhe sidomos intelektualët.

Patjetër është e vështirë – por jo e pamundur!

*** Poezi *** Poezi *** Poezi *** Poezi *** Poezi *** Poezi ***

TRIBUNA E HISTORISË

Një ditë feste e përkujtimi
Atmosferë ku buron nderimi
Me miërnjohje është urimi
Shkëmbim mendimesh për histori
Kronikë ngjarjesh me lavdi
Dy përvjetor me shumë rëndësi
Për kulturë dhe histori
Njëqind vjetori i arsimit
I 15-ti vit i gazetës së Dukagjinit
Me shoqatën atdhetare
Bënë emër me lavdi t' madhe
Hartoj programin, realizoj detyrat
Me pëndë në dorë, shfletoj arkivat
Hapën epokën e lavdisë
Me mjaft ngjarje të historisë
Saktësuan realisht të vërtetën
Me fakte patriotike ushqyen gazetën
Heroizmin t' zhvilluem në shekuj
Simbol vlerash n' historinë shkencore
Qëndresa e trimave në fitore
Për liri, besë e troje
Qëndruan të fortë, gishtin në qark
Hisrorinë e shkruan me gjak
Këto qëndresa bënë epokë
Në arkiva ruhen në Evropë
Shoqata e jonë atdhetare

Me ndërgegje, punë vullnetare
Me ide patriotike e përkushtim
Meritojnë shumë falënderim
E gjithë shoqata padallim
Dhe kryesinë për organizim
E redaksinë për aftësi e burrëri
Për artikulim me shumë rëndësi
Në kulturë e histori
Punë cilësore e humane
Botua gazetën, libra e romane
Përkujtime t' ngjarjeve madhore
Ndërtuan buste e përmendore
I naltësoj trimat e motit
Dukagjini “NDERI I KOMBIT”
Me germa t' arta në altar shkruar
Për shumë shekuj me u naltësue
Shkodra pa këtë histori
Mbetet si dita pa diell, por me shi
Dukagjin o shpirti im
Historinë tënde e kemi shpërblim
Na jep nderë e guxim
Ne, gjaku yt në mërgim
Me emocione, atmosferën e gëzimit
Në përvjetorin e gazetës së Dukagjinit
Tribunë vlerash të patriotizmit
Me të drejtën tonë morale
E vendose historinë në pedestal

Me vlera kombëtare e vatan
Shkodra me kulturë e universitet
Dukagjini me histori e gazetë .

Pjetër Geraj, Bruksel

QYTETIT TIM

RrëzëTaraboshit
Rrugës per Shirokë
Hipur ne biçikletë
Unë e bëj me shokë

Nënjelokal u ulëm
Kafedhamëporosi
Kamarieri i qeshur
Ishtenjëdjale i ri

Flladi i liqenit
AromëTaraboshi
Me dhanëfuqi
Si me qenë i ri

Natyra e bukur
Me ujë e male
PërballëRozafa
Si njezonjë e madhe

Zotinadhënë
O mojShkodrajonë

Bukurinë tënde
Lumkush e jeton.

REFUGJATI

Rrugët e mërgimit
Fëmijëtkanëmarrë
Shqipëri e vogël
Nëbotëështëshpërndarë

Ata u larguan
Se izurihalli
Vendin e braktisën
Dheithaumalli

Njëditë do tëvijmë
I kërkonvatani
Nëna me babanë
U thanësëqari

Lotëtqërrjedhin
Janë lot malli
Rrëkeja e tyre
Si burimmali


Kadhe lot tëtjera
Qëjanëgahalli
Dhimbjamë e madhe
Ku mungondjali.

Përparim Sulo Hasani

2018-Viti i Gjergj Kastriotit-Skenderbeu

GJERGJ KASTRIOTI, HEROI YNË KOMBËTAR

- FJALA E PAVDEKSHME PËR TË GJITHA GJENERATAT SHQIPTAR... -



nga **Mejrme Gjocaj**

Ja si është shprehur Gjergj Kastrioti:

“Jam në prag të varrit. Po ju lë një mbretëri me forca

të afta për ta mbrojtur, por me një pasardhës të paaftë nga mosha për ta drejtuar. Megjithatë, në qoftë se në të ardhmen ju bëheni trima dhe të virtytshëm, ju mund të përballoni të gjitha sulmet e armiqve tuaj. Nuk është sipërfaqja e vendit ajo që bën një fron të respektueshëm, por aftësia e atij që ulet mbi të. Në qoftë se ju jeni i djallëzuar, shërbëtor i ministrave tuaj, dhe naiv i lajkave të oborrtarëve tuaj, atëherë asgjë nuk do të jetë më e lehtë sesa përmbysja nga maja më e lartë ku ju ndodheni. Duhet të jetë virtyti themel i fronit. Virtyti nuk është fantazi. Ndoshta do ju a thonë një ditë, por mos harroni se ai që do ju a thotë, është një tradhtar, një dinak, që për të mbretëruar në vendin tuaj, do ju sugjerojë maksima të rreme, të cilat herët a vonë do të shkaktojnë përmbysjen tuaj. Duke pasur virtytin si udhërrëfyes, lajkatarët dhe të pabesët do të largohen prej jush...Të virtytshëm, ju mund të mbani lehtë perandorinë që po ju lë të tronditur nga lufta e vazhdueshme ; ta përforconi, ta rimëkëmbni nëpërmjet pushimit dhe qetësisë...

Krijoni vend-shkrime të pa censuruara në të gjithë sipërfaqen e mbretërisë ku mund të publikohen të gjitha padrejtësitë dhe dhuna që mund të ushtrohen nga drejtuesit e krahinave tuaja. Bëni këtë edhe për miqtë apo familjarët e tyre që jetojnë në oborrin tuaj, të cilët i fshehin këto shkelje apo i përdorin nën pretekstin e drejtësisë dhe të domosdoshmërisë. Shqyrtoni gjithçka nga ju vetë, dhe nëse magjistrati, ushtari apo kleriku janë mashtrues dhe të padrejtë, atëherë pa mëshirë varini në shtyllë në vendin e krimt : ju do të vini re se pasardhësi i tij do të bëhet i drejtë dhe i njerëzishëm... Kur sapo të keni marrë drejtimin e pushtetit, ju do të kujdeseni për Drejtësinë, e cila është themeli i të gjitha virtyteve. Ju do të mbronni artizanët, si njerëzit më të dobishëm të zonave të pushtetit tuaj, dhe do të parandaloni shtypjen e tyre nga pasanikët. Krenaria dhe luksi i bën pasanikët të pandjeshëm ndaj fatkeqësive të varfërve, të cilët nuk kanë as tituj (grada) e as mbështetje. Duhet të jeni të butë dhe të dashur me njerëzit tuaj ; dukuni shpesh mes tyre, bisedoni me ta, pyesni ata nëse dëshirat tuaja për drejtësi janë ekzekutuar nga ministrat tuaj. Princi që qëndron i mbyllur me oborrtarët e tij shikohet nga populli i tij si armik dhe tiran...Dëgjoni ankesat dhe kërkesat e popullit tuaj me qetësi sa që ti frymëzoni besim atij për t'ju ndihmuar të korrigjoni abuzimet dhe fatkeqësitë e shtetit.

Kujdesuni që Kombi juaj të rritet nëpërmjet fesë katolike, por mos perseku-

toni asnjëri që ta ndjekë atë me detyrim. Dielli, që është shëmbëllimi i Perëndisë, shkëlqen pa dallim për turkun ashtu si për të krishterët. Kushdo që këshillon për të luftuar për hir të Perëndisë është një mashtrues i cili dëshiron të sakrifikojë të vërtetën për interesat e tij. Zoti është i

jtudo që flet në emër të Zotit me qëllim për të heshtur mbretin dhe drejtësinë. Ju do t'i mbronni ata kundër zellit të tepruar të drejtuesve hipokritë duke i shpërblyer me vende pune në gjykatat dhe oborret tuaja.

Kur të ju flasni keq për dikë, ju do ta dëgjoni me gjysmë veshi... Ju do të jeni

jeni të brishtë për t'ju akuzuar dhe do të pohojnë pretendime të rreme mbi trashëgiminë që po ju lë. Mos përdorni spiunë për të ditur se çfarë thonë njerëzit në lidhje me administrimin tuaj. Bëni punën tuaj ashtu si duhet, njerëzia le të flasni dhe të shkruajë çfarë të dëshirojë...

Ti jepet mundësia gjithsecilit prej rrethit tuaj që të ju shkruajë ; Ju do të punësoni sekretarët tuaj që të përgjigjen për çështje të ndryshme ose publike, por sekretet e shtetit duhen të mbeten mes jush...

Mos përbuzni askënd ; më i vogli dhe më i varfëri mund të ju rrëzojë, ashtu si dhe mund të ju ndihmojë me këshillat dhe kurajën e tij.

Jeni të durueshëm në çështjet e luftës, të patrembur në rreziqe, të butë dhe humanë, kurrë mizorë dhe gjaknxehtë. Fshihni dhimbjen që fatkeqësitë tuaja mund të ju shkaktojnë. Armiqtë tuaj do të jenë gjithmonë të gatshëm të ju fyejnë për fatkeqësitë, dhe ministrat të ju tradhetojnë. Ftoni mes jush të huaj të arsimuar duke u dhënë një rol këshilltari edhe në rast kur ata nuk janë fisnikë e të pasur. Kompetencat që i akordohen fisnikërisë janë prodhim i politikës. Ju mund të përdorni fisnikët si të dëshironi. Pasanikët injorantë do t'i lehdhoni, kështu do të kurseni pasurinë tuaj për mirëmbajtjen e ushtrisë, dhe do të keni një oborr të shkëlqyeshëm falë krenarëve por dhe budallenjve, që nuk kanë asnjë lloj virtyti përveçse floririt.

Mos jeni të ndrojtur ndaj ndjenjave tuaja. Deklaroni haptazi oborrtarëve tuaj, se ai që do të ju gënjejë dhe do të ju dërgojë në rrugën e gabuar në administrim, pa asnjë falje do të varet në shtyllë. Poetëve që do të ju thurin vargje, për të ju bindur se jeni më i madhi, më bujari, më i mrekullueshmi, luftëtari më i madh ndër të gjithë mbretërit, u dërgoni në këmbim një copë letër, bojë dhe një pendë nga një oborrtar i panjohur, me urdhrin për të dëshmuar të vërtetën e asaj që shkruajnë, dhe në qoftë se nuk mund të bëjnë një gjë të tillë, të kufizojnë veten në dhënie të këshillave, duke u lënë të kuptohet se nëse vazhdojnë të shkruajnë marrëzira të tilla të rrezikshme, ata do të mbyten nga vetë ju si person i shenjtë i të vërtetës.

Kujdesuni që të keni gjithmonë ushtarë të mirë dhe të disiplinuar ; që ushtarët tuaj të mos bëhen përtacë, ti stërvitni dhe ti trajtoni jo si skllavër por si shokët tuaj. Kur të jeni në luftë, ju do të udhëhiqni ushtrinë si gjeneral dhe në betejë do të luftoni si ushtar. Emri i mbretit është një titull shumë i nderuar, por ky titull ka peshë të madhe dhe detyra të vështira për të realizuar. Kryesorja është të pranohesh dhe të respektohesh në rrethin tënd. Zoti nuk ka dhënë fuqinë supreme për të na zhytur në qullësi, për që të jemi mbrojtës të çështjes publike. Për një zemër të butë dhe një shpirt të virtytshëm, mirëqenia e përgjithshme e po-



fuqishëm, ai mund të bëjë gjithçka vetë, pa ndihmën e askujt...Në qoftë se fati ju bën endacak, të varfër apo nevojtar kurrë mos e ndryshoni fenë për interes...Mbyllini që në origjinë mosmarrëveshjet e teologëve dhe hipokritëve, të cilat janë më të rrezikshmet për lumturinë e një shteti. Kemi parë perandoritë më të lulëzuara të përçahen dhe të tronditen nga këta fanatikë...Shihni Perandorinë e Konstandinit të rrënuar dhe princin Jean Paléologue (Gjon Paleologu) i shkelur nga kuajt e Arabëve. Ai ishte supersticioz, priftërinjtë e tij ambiciozë dhe injorantë, oborrtarët e tij të rremë dhe të shthurur nga luksi, dhe tani princi, priftërinjtë dhe oborrtarët kanë vdekur dhe po vdesin në skllavëri.

Nëse keni fat të mjaftueshëm për të pasur filozofë në vend-qeverisjet tuaja, të cilët janë të ndriçuar nga drita e arsyes dhe jo nga sistemet e rreme, le të shkruajnë në paqe dhe të reagojnë ndaj paragjyqimeve dhe makinacioneve të ku-

të sjellshëm me të gjithë shtresat popullore. Si arsye e dallimit të gradës që do të keni së shpejti në shoqëri, ju duhet të dalloheni nga të tjerët nëpërmjet bujarisë, i cili është karakteri dallues i princave. Një monark, edhe i varfër, duhet të jetë bujar...

Mbronni meritën dhe shpërblejeni atë kudo që ajo ndodhet. Mirësia duhet të shoqërohet me një zemër bujare. Njeriu ndërton tempuj, ngre altarë për Zotin falë mirësisë së tij. Evitoni për gjithmonë shekullit, rrethit dhe rracës tuaj turpin për të pasur njerëz të dëshpëruar nga mizoria, krenaria apo injoranca juaj. Mos harroni se njeriu lind për lumturinë e njëritjetrit...

Armatosuni nga guximi dhe vendosmëria në mjerim, me maturi në mirëqenie. Mos u zhytuni në përtaci, ajo është nëna e të gjitha veseve...Mos mbyllni sytë ndaj fqinjëve dhe traktateve të tyre : ata do të presin momentin kur ju do të

pullit tënd është kënaqësia më e madhe që mund të përjetohet. Neglizhenca dhe një lloj mirësie që e thërrasin « mendjelehtësia e një princi », u shkaktojnë dëme njerëzve ; dhe ju e dini se roli i mbretit është t'i mbrojtë

Dëboni larg jush astrologët gjykatës dhe kimistët prodhues ari dhe diamantesh. Një princ është gjithmonë i pasur, kur ai është i mençur dhe i lartësuar shpirtërisht. Emri juaj do të jetë i shkruar në një pllakë prej mermeri të bardhë me shkronja të zeza mbi dyert e kështjellave tuaja të destinuara për të burgosurit. Mjerim për guvernatorin që i fshehu mbretit pafajësinë, që përkeqësoi nga koprracia dhe zelli i tij dënimin e fajtorëve... Mbroni njerëzit e dashur dhe të mirë, ndëshkoni shpirtat e këqij. Jeni të ndjeshëm ndaj lëndimit, por akoma dhe më shumë ndaj shërbimit të popullit tuaj dhe miqësisë të njerëzve të ngjashëm me ju.

Pika kulmore e një lufte është çorientuese, duhet ndërjerë pasiguria (rreziku). Atëherë kujdesi dhe guximi do të ju shërbejnë më mirë se sa pasuria. Duhet të dish të fitosh, por mos harroni se edhe mund të mposhtesh. Sfidoni veten tuaj : mos e humbisni toruan nga zemërimi, sepse atëherë i thjeshti bëhet i keq dhe mbreti një përbindësh...

Mos harroni se politika turke është për të mbjellë përçarje mes princave të krishterë; e gjithë madhështia e tyre gjendet në këtë politikë të shkëlqyeshme, e cila bën me shumë pushtime sesa armët e tyre. Së fundi, në qoftë se jeni xheloz se po ju lë një trashëgimtar që ju pengon për të marrë fronin, mos harroni se kam



qenë babai juaj, dhe shpatën do e përdorni vetëm për të rrëzuar armikun.

Ju do të keni lidhje të shumta me oborin e Romës, që unë kam qenë deri tani mbështetës dhe mbrojtës. Interesat e mia më kanë detyruar të përshtat politikën time me të sajën. Rrethanat në të cilat jam gjetur veten nuk më kanë lejuar të luftoj uzurpimet turke dhe pretendimet e papës. Për të mirën e krahinave të mia kam qenë gjithmonë i lumtur me veprimet që kam ndërmarrë. Roma është fodulle vetëm me princat e dështuar. Roma, duke më pasur frikë, më ka bërë gjithmonë lajka. Ajo ndryshon maksimat dhe pozicionet sipas rasteve, por frika se humb tokat e saj ndaj sulmeve të Muhamedit, e ka detyruar atë të qëndrojë modeste ndaj meje, duke më njohur të gjitha të drejtat, titujt, dhe zotërimet e realizuara gjatë betejave të mia. Papët nuk kanë arritur kurrë të manipulojnë një ushtar të vjetër si unë, por nuk do të hezitojnë të bëjnë një gjë të tillë ndaj

jush si arsye e moshës së re dhe mungesës së eksperiencës për të qeverisur, për të shërbyer. Mos harroni, se me praktikatat e shumta që ata përdorin për të arritur qëllimet e tyre, më e forta, është rrëfimi. Por është e lehtë ta kuptoni : kur prifti do të dojë të dijë më shumë sesa mëkatet tuaja, kthejeni si një mashtrues në vendin e tij, dhe dënojeni si të tillë, që të shërbejë si shembull për pasardhësin e tij.

...Megjithatë, është shumë e rrezikshme të kundërshtosh hapur Papën, këtë idhull të madh të fesë sonë. Ai është një njeri si të tjerët, me pasionet dhe dobësitë e tij... Nëse Papa ju dërgon faljet, reliket, bekimet, merrni ato me respekt, dhe nderoni me njerëzit tuaj duke e dhënë ju shembullin kryesor... Por në qoftë se Papa përpiket të rrisë numrin e priftërinjve dhe murgjve për të nxjerrë para nga krahinat tuaja...ose ju nxit që të hapni luftëra në emër të Zotit, rrufeja hakmarrëse që lloftë mbi ju dhe pasardhësit tuaj në rast pra-

nimi. Zoti hakmerret ndaj fyesve të tij, pra nuk ka nevojë për ndihmën e njeriut. Mos kërcënoni Romën, kur ajo nuk ju kërcënon. Por shpallni luftë ndaj kujtdo që mundohet të prishë harenë e popullit, dhe legjitimitetin e fronit.

Ju do të ndaloni çdo banor i cili ndodhet nën qeverisjen tuaj, që të mos bëhet as prift e as murg pa arritur moshën dyzet vjeçare. Për tu ushqyer nga puna e të tjerëve, duhet më parë që njeriu (mashkulli) të ketë kontribuar në mbështetjen e komunitetit, prej të cilit dëshiron të ndahet për të shijuar jetën e tij... Këta priftërinj dhe murgj duhet të ju ndihmojnë të mbroni kombin në kohë lufte, sepse në kohë paqeje po ky komb i ushqen pa i përdorur. Nëse Papa kundërshton, bindeni atë me butësi, dhe vetëm në qoftë se është e nevojshme përdorni shpatën... Një politikë e tillë do të ju pajtojë me dashurinë atërore të pasardhësve të tij, dhe do të bëheni shembull dhe lider për të gjithë mbretërit, të cilët frikacakë, të dobët, injorantë, budallenj, u uzurpohet nga Papa dhe ministrat e tyre, fuqia që Zoti u ka dhënë për të përhapur lumturinë e Kombeve, ku ata duhet të jenë zotërit dhe etërit.

*Ky libër gjendet tek Papa në Rome. Përkthyes janë shume, në mes tyre Aurenc Bebja-France.

Ky fjalim është marre nga libri "Le grand Castriotti d' Albanie, Historie", me autor Stephan Zannovich, botuar ne vitin 1779, nga shtëpia botuese J. J. Kesler, Frankfurt, me 131 faqe, ne faqen 70 - 89

PENSIONISTËT TË LËNË NË HARRESË

Nuk është e thënë kot se çudia më e madhe zgjatë tre ditë. Po tani, kur çdo ditë ndodhin me dhjetra çudira. Këto nga forma e permbajtja janë të nryshme. Po kulmi i atyre arrinë në akuza e kundra akuza nga pole të ndryshme të politikës. Me sa duket janë në garë, kush akuzon më shumë, kush fletë më bukur dhe kush ironizon më shijeshëm etj.. Flasin për korupsionin, për drogën, konçesionet, çfarë është bërë e çfarë po bëhet, sikur këta janë njerëzit më të pafajshëm. Nuk kanë bërë as nuk po bëjnë asnjë gjynah. Ne qytetarët e këti vendi rrimë e veshtrijmë e veshtrijmë dhe habitemi! A thua e kanë me gjithë mend Ndersa ne mendojmë si do ja dalim të përballojë jetën e pëditshme! Në këtë shtresë më të lodhur janë pensionistet, jo nga vitet që mbajnë në kurriz, po nga gjendja ekonomike me të cilën perballen çdo ditë. Ata kanë punuar një jetë të tërë, në fronte të veshtrija sin ë miniera, nderim, hidrocentrale, bonifikim në kooperativa bujqësore etj. Një fjalë e urtë thotë " Kaloresi nuk ja beson këmbësorit" Një grup jo i vogël dihet se jeton në një luks, ku mundet me ua pas lakmi edhe jetës që bëjnë sferat e larta në vendet e perparuara perëndimore. Këta mund ti quajmë " Baballaret e kombit" Këtu nuk bëjnë perjashtim për asnjë nga 140 parlamentarët, si dje edhe sot. Pensionistet janë po në të njëjtën gjendje për 27 vjet. Pensionistet dhe shtresat e tjera që jetojnë në një fu-

karallek të tej skajshem. Duhet të jetë në qender të vemendjes, integrimi i ketyre shtresave. Po pergjegjësi kanë edhe vetë pensionistet të cilët duhet të jenë të bashkuar, pa ngjyrimë politike. Duke ngritur zerin e tyre në të gjitha instancat e qeverisjes, vendore apo qendrore. Në optikën e parlamentarëve ka qenë dhe është problem, vetem si të rritin rrogat e tyre, në sa komisione do marrin pjesë, në të cilin universitet mund të japin leksione, në sa borde do të aktivizohen, sa udhëtime mund të bëjnë neper botë etj. Madje bëjnë ligje që edhe pasi të ikin nga politika t i gezojnë të gjitha ato privilegje. Këto ju takojnë për " të mirat" që ju kanë sjellë, pensionistëve dhe të shtresave të tjera në nevojë.

Janë hapë e hapen tendera, konçesione në shumë drejtime deri edhe per ekspert të specializuar në dikastere të ndryshme. Po shqipetarët të cilët janë specialozuar në prenim pse i ofendojmë? Do të ishte mire të reduktoheshin këto shpenzime dhe të perdoreshin për shtresat në nevojë. Jemi dakort që kush shkel ligjin të pergjigjet. Shteti dhenjet e lejeve të ndertimit, të cilat I kanë dhenë nepunësat e tyre ti dëmshperblejë nga taksat e qytetareve, siç ndodh me prishjen e ndertimeve, ku taksa paguesit Shqipëtarë paguajnë me mijëra e mijëra euro. Partia në pushtet fitoi bindshëm në zgjedhjet parlamentare, në mes të ketyre votuesve janë edhe votat e pension-

istëve. Sipas llogaritjeve të bëra rezulton se 60 per qind e pensionistëve e kthyer në vota del se 390000 vota ja kanë dhënë Edi Rames për ryeminister. Me bindjen se u bënë disa reforma, fillojë me u ndje shteti, u bënë edhe premtime për rritje pagash e pensionesh, për pagën e 13, për shperblimin e fund vitit etj. Askujt nuk i shkante ndermend se në vitin 2016 këto do të ishin më të larta se në vitin 2017. Madje " gojë e liga " thonë se na rrejtën sa na morën votat. Ne mendojmë se plot vende ka se ku mund të kuseheshin fonde e të shkojnë për shperblimin e fundvitit të pensionistëve e të shtresave të tjera në nevojë. A nuk është turp me këtë qendrim qe mbahet ndaj moshës tretë? Thuhet se do rriten pensionet, për vitin 2018 me 2 per qind. Pra kjo rritje varion nga 200 deri në 800 lekë, ose e thenë ndryshe me ble nga 2 deri në 8 kg. molla në muaj. Shperblimi I fund vitit ishte qesharak. Ku mund të merrje një të katertën e gjelit të detit. Si gjithë qytetarët e tjerë edhe pensionistet do paguajnë energjine elektrike, ujin e taksa të tjera. Do marrin ilaçet ku mesatarisht varion nga 3000 deri në 5000 lekë në muaj, se ato me rimbursim nuk janë të cilësise duhur. Bile vet mjekët të thonë, merri ilaçet të prodhimeve nga fomaceutika të vendeve të BE. Siç u shpreh një pensionist në deshprim e sipër se shperblimi I dhënë nga qeveria në fund të vitit, prej 3000 lekeve nuk perballlova as ilaçet

e një muaji. Të ilustruam me një shembull. Një pensionisti nga Dukagjini, për të udhtuar për në Shkoder, vetem transporti i kushton 1400 leke. Vizitat bëhen çdo muaj, kuptohe " falas". Pastaj ilaçet rreth 3000 leke. Kur pensioni varion nga 8000 deri 10000 lekë. Nuk ka nevojë për koment se sa lekë mbeten për ushqime, energji elektrike etj. Pra ky është turpi që hahet me bukë tash 27 vjet. Shumica e pensionistëve, ngushllimin e gjejnë te fëmijët e tyre në emigracion të cilëve ju kerkojnë para për të festuar festat e fundvitit. Duke qenë koshient se vitin tjetër, një pjesë e tyre mund t i " festojnë" në botën tjetër. Qeveria dhe gjithë shoqëria duhet të mendojnë me shumë për këto shtresa. Të cilët një jetë të tërë kanë punuar për të gezuar ditët e mbetura. Po me këto pensione as hidhrimet për qoke nuk perballon. Shpresa vdes e fundit, por ajo po venit se qeveria aktuale në mandatin e dytë nuk po arrine të gëzojnë me një rritje të pakten në masën e 5 perqindeve. Pasi siç thotë vet " tepsinë" e qeverisjes e ka vetem. Po perseri pensionistët duhet të jenë optimist se parlamentarët, qeveritarët do mendojnë se do ju vij koha atyre dhe të afermëve të tyre per tu bërë pensionista. Duke ju bërë thirrje që të mendojnë per rritje në një masë më të madhe pensione.

Nga Ndue Ziçi

NDAHËT NGA JETA PIKTORI I MIRËN JOHUR NDOC GURASHI

“ANËTARI I NDERIT TË SHOQATËS ATDHETARE DUKAGJINI”

Përcillet për në banesën e fundit piktori dhe intelektual I njohur I Shkodrës Ndoc Gurashi.

Ndoc Gurashin një nga emrat më të mëdhenj te artit figurativ shkodran e shqiptar mbylli sytë në moshën 95 vjeçare. I vlerësuar me shumë çmime e tituj, me ekspozita të hapura brenda dhe jashtë vendit, ai do të mbetet në memorien e të gjithëve si një nga personalitetet e shquara të Shkodrës, ashtu siç në vetvete ishte edhe familja e tij. Shkodra humbi një nga artistët më të madhë të këtij qyteti, I cili gjithë jetën ia kushtoi artit dhe edukimit artistik të brezave.

U nda nga jeta, me datën 17 shkurt 2018 një nga emrat më të mëdhenj te artit figurativ shkodran e shqiptar, piktori Ndoc Gurashi, tre dite pas ndarjes nga jeta të bashkëshortes së tij, Jolanda Gurashi, Halles Landi.

Ndoc Gurashi, u lind në prill të vitit 1925, në Shkodër.



Rrjedh nga një familje me traditë në fushën e artit. Banesa ku ka lindur dhe jeton është ndër më karakteristike në Shkodër, ku sapo hyn përballësh me traditën, me orenditë e vjetra, që familja Gurashi ka ruajtur me fanatizëm brez pas brezi. Po krahas këtyre relikeve, të gjitha muret e brendshme të kësaj banese mbartin pikturat e realizuara ndër vite nga Ndoc Gurashi, piktori që mban titullin “Mjeshtër i Shquar në profesion”, si dhe disa medalje dhe çmime për tablotë që ka realizuar gjatë 50 viteve në këtë profesion.

Kryen gjimnazin franceskan “Illiricum”!

Në vitin 1957 merr pjese në ekspozitën e pare lokale të pikturës

Në vitin 1964 diplomohet për picture, në Tiranë.

Në vitin 1973, është anëtar i Lidhjes së Shkrimtareve dhe Artistëve të Shqipërisë

Në vitin 1993 hap ekspozite vetjake në Bari, Itali

Ka një koleksion me mbi 150 punime
Në vitin 1962 dhe 1970, dekorohet me “Medalja e Punës” nga Presidiumi i Kuvendit Popullor

Në vitin 1976, Kuvendi Popullor i jep titullin “Mjeshtër i shquar në profesion”

Në vitin 1978 merr çmimin e dytë në një ekspozitë kombëtare me punimin “Një marshim i vështirë”

Në vitin 1983 Kuvendi Popullor e dekoron me urdhërin “Naim Frasheri” i klasit të dytë

Në vitin 1985, Presidiumi i Kuvendit Popullor i akordon medaljen “Për shërbime të shquara shoqërore dhe shtetërore”

Në 2005, Këshilli Bashkiak i Shkodrës i jep titullin “Miënjohja e Qytetit të Shkodrës”.

Në vitin 2008, Kryesia e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, i jep titullin “Anëtar Nderi i Shoqatës”

Ndue Sanaj, Gjergj Leqejza, Luigj Shyti, Prele Milani e Lazer Kodra

AGJENSIA INTESVTIGATIVE ‘STOP KRIMI’: 4 VJET NË NDIHMË TË SHTETIT

NGA ARBEN LAGRETA *

Drejtori Ekzekutiv i Agjensisë Investigative “Stop Krimi”, Fatmir Sena, ndërmjet të tjerash u shpreh: “Agjencia Investigative Stop krimi” është e llojit informues dhe sensibilizues për të prandaluar çdo gjë të paligjshme. Ajo shtrihet me antarë si brenda dhe jashtë në Evropë edhe ku është vlerësuar si e suksesshme në punën e saj. Duke u ndalur në këtë pikë, neve jemi vlerësuar nga partnerët tanë në Europë për punën tonë në favor të drejtësisë dhe të shtetit shqiptar.”

Para pak javësh është përkujtuar 4-vjetori i themelimit të Agjensisë Investigative “Stop Krimi” në një Konferencë Kombëtare të organizuar në Tiranë ku ka edhe selinë.

Ishin të pranishëm drejtuesit, anëtarët dhe simpatizantët e kësaj agjensie investigative si dhe mjaft personalitete të njohura të fushës së rendit dhe të sigurisë në vend.

Nën moderimin e Drejtorit të Koordinimit për Europën të kësaj agjensie si dhe në të njëjtën kohë të ekspertit të sigurisë Bashkim Abazi, raportin për veprimtarinë 4-vjeçare të Agjensisë Investigative “Stop krimi” e mbajti Drejtori Ekzekutiv i saj, Fatmir Sena.

Kanë diskutuar edhe drejtues të tjerë të kësaj agjensie si Drita Sefa, Koordinatore në Marrdhëniet me biznesin, Desantila Domi, Shefe Koordinimi e kësaj agjensie me Francë, Shkelzen Kreci Koordinator i kësaj agjensie në Greqi etj.

Vlen të përmendet prezenca nga të



ftuarit e ish-Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Veli Myftari i cili nga ana e tij përshë ndeti konferencën me rastin e 4-vjetorit të krijimit të kësaj agjensie, ashtu si edhe Perlat Kurti, edhe

ky funksionar i lartë i policisë.

Në fund të konferencës organizatorët bënë shpërndarjen e certifikatave të mirënjohjes për shumë kontributorë të kësaj agjensie ndër vite. Kështu u ndëruan me këtë certifikata, Drejtori Ekzekutiv i kesaj agjensie Fatmir Sena dhe në vijim drejtues dhe anëtare të tjerë të kësaj agjensie, e konkretisht: Bashkim Abazi, Zamira Mehaj, Drita Sefa, Desantila Domi, Shkelzen Kreci, Afërdita Ferracaku, Spiro Bezhani, Marjeta Karaj, Alketa Kopaci, Aderatik Ndrëgjoni, Martin Cukeli, Vjollca Blloshmi, Afrim Mavriqi, Arjan Hoxha, Met Ramazani, Geart Akli, Lindita Fejzo, Robert Miftari etj.

Në ndërkohë sipas prononcimit të Drejtorit Ekzekutiv të Agjensisë “Stop Krimi” Fatmir Sena përsa i takon natyrës së aktivitetit të kësaj agjensie:

“Në Konferencën Kombëtare të sotme për nder të 4-vjetorit të agjensisë sonë falenderuam të gjitha anëtarët e saj për bashkëpunimin e tyre të frytshëm brenda dhe jashtë vendit. Agjenda jonë investigative është informuese dhe sensibilizuese kundër krimit, akteve terroriste, drogës,

korupsionit si dhe trafikimit të femrave dhe të fëmijëve. Në këtë kuadër ne kemi sensibilizuar opinionin publik duke shpërndarë fletëpalosje dhe kemi bërë një punë të mirë për parandalimin e fenomeneve që përmenda më lart jo vetëm me anëtarët tanë në Shqipëri por edhe jashtë. Agjensija Investigative, informuese dhe sensibilizuese “Stop krimi”, terrori, droga, korupsioni, trafikimi i femrave dhe fëmijëve është e llojit informues dhe sensibilizues për të prandaluar çdo gjë të paligjshme. Ajo shtrihet me antarë si brenda dhe jashtë në Europë, nga edhe ku është vlerësuar si e suksesshme në punën e saj. Duke u ndalur në këtë pikë, neve jemi vlerësuar nga partnerët tanë në Europë për punën tonë cilësore në favor të drejtësisë dhe të shtetit shqiptar.”

Ndërsa duke u ndalur në periudhën e fundit të përmblytjeve në vend, Drejtori Ekzekutiv i Agjensisë Investigative “Stop Krimi” Fatmir Sena informoi: “Anëtarët e agjensisë sonë janë angazhuar seriozisht për të mbledhur ndihma në ushqime dhe veshje për banorët e dëmtuar nga këto përmblytje, duke qenë kështu një mbështetje edhe në veprimtarinë e shtetit në këto situata emergjente që sapo kaluam në muajin dhjetor 2017. Viti 2018 do të jetë me të vërtetë një vit i angazhimeve akoma më të mëdha për Agjensinë Investigative “Stop Krimi”.

ARBEN LAGRETA

* Autori është Koordinator Rajonal i Veriut

DOSJA E HAPUER HETIMORE E MARTIRIT GJELOSH LUSHI NGA SHOSHI!

AKT AKUZA NR 402. SHKODËR, ME 20.07.1945

Pas arrestimit Prokuroria Ushtarake e Rrethit Shkodër me Letër –rreshtimi nr 359, kundra Gjelosh Lushit, i biri i Lushit dhe i Soses, vjeç 32, nga Katundi Pepsuj, Shosh akuzohet si **Armik i Popullit** në bazë të Nenit Nr .1.të Ligjës nr 21 datë 15.12.1944.

Unë Prokurori (*Armit Çela nenvizimi im P.M*) në bazë të nenit 20 paragrafi 4 i ligjës mbi organizimin dhe funksionimin e gjykatës Ushtarake urdheroj:

Reshtimin për një kohë të caktuar në burgun e armiqve të popullit Shkodër.

Organet e M.P.Policisë dhe çdo fuqi e armatosur ngarkohet për zbatimin e këtij letër rreshtimi¹. Gjelosh Lushi qëndroi në hetuesi plot 18 muaj, duke përbulluar në menyrën më dinitoze të gjitha llojet më ekstreme të gjinisë së torturës. Në dosjen e tij gjyqësore ishte përpiluar kjo akt akuzë nga Prokuroria Ushtarake.

“I pandehuri i rreshtuem Gjelosh Lushi nga Katundi Pepsuj akuzohet se:

Duke qënë në shërbim të pushtetit tonë Popullor si Antarë i Gjyqit në Dukagjin, tu përfitue nga kjo pozitë, ka sabotuar punën q’i i ka besuar populli dhe ka hedhur parulla helmtonjëse kundra pushtetit të sotëm me qëllim që të krijonte pakënaqësira në popull ta përçante dhe ta largonte nga pushteti i tij.

Në lidhje dhe në bashkpunim me të arratisur kriminel lufte dhe armiq të popullit Gjergj Vatën dhe Mark Malën është munduar dhe përpjekur që të përgadisë banda reaksionare që të jenë gati për t’i rënë pas shpine Qeverisë.

Është përpjekur që të grumbullojë sa me tepër popull rreth vetit për t’a pasë gati për çdo eveniment.

I pandehuri njihet si element i rrezikshëm pasi ka tradhëtuar interesat e popullit².

DEPONIMI NË HETUESI

Me datën 22 qershor 1946, një ditë pas arrestimit në Komandën e Rrethit Dukagjin ish Kryetari i Frontit të këtij rrethi Gjelosh Lushi, tashmë në cilësinë e të pandehurit, merret në pyetje nga Shefi i Seksionit Sigurimit Shtetit Major Zoj Themeli dhe N/Toger Xhemal Selimi ku në prezencë të tyre u përpilua ky proces verbal.

Është përpjekur në bashkpunim me Prof. Kolë Prelën, Zef Nikën dhe Lekë Vojvodën që të grumbullojnë sa me tepër popull rreth vetes që të jenë gati për çdo eventualitet.**Mbasi u pyet me vullnetin e tij deklaroi:**

-Gjatë rregjimit të Zogut, nga që kisha ushqyer të arratisurit politik me

bukë, jam burgosë nga qeveria dy herë, por nga miqësia që kam me bajraktarin e Shalës, Kolë Ndoun më kanë pasë nxjerrë nga burgu duke mos më lënë më gjatë se 3-4 ditë. Burgosë jam një herë në vitin 1937 dhe një herë në vitin 1939.

-Pas ardhjes së Italisë jam takue me Prof Kolë Prelën dhe Mark Ndojën dhe kam punue me ta deri në çlirimin e plotë të Shqipërisë

Kolë Prelën e kam mbajtur në shtëpi me bukë gjatë kohës së luftës, po ashtu Mark Ndojën e shumë të tjerë.- Mbas çlirimit jam emëruar Kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Nënprefekturës Dukagjin.- **Unë Kolën e kam dashtë ma shumë se çdo njeri tjetër dhe për të unë bajsha çdo send, sikur Kola të më thoshte të vras edhe një njeri.d.m.th e deshta pa masë dhe bëja çfarë të më thoshte ai., për këtë arsye u lidha me të dhe fillova të punoja si më thoshte ky.**

- Në kohën kur do të rrezonin Prof Kolë Prelën (Është koha fill pas deklaratës së bujshme 14.02. 1946 që bëri profesori në mbrojtje të Pater Gjon Shllakut dhe grupimit të ashtu quajtur të klerikëve reaksionar të Bashkimit Demokristjan nenvizimi im P.M), unë



punova me gjithë fuqitë e mija dhe jam përpjekur në çdo anë me miqtë e fisit tem duke i thanë popullit të mos lëshonte deklaratë që rrezonin Kolë Prelën por të thoshin që e duam Kolën, më gjithë përpjekjet e mija Kolën e rrëzoi populli mbasi ky kishte mbrojtur ata që u denua nga gjyqi si tradhëtar e kriminel lufte.

-Pasi rrezuan Prof Kolë Prelën mu prish qefi mjaft dhe mbeta as këndeje as andej.

-Në këtë kohë kisha frikë me fol me këdo prandaj flisja vetëm me Prelë Markun, Zef Nikën dhe Lekë Vojvodën, mbi pakënaqësitë që kisha.

-Kam bisedue me Zef Nikën dhe Lekë Vuksanin (*Vojvoden*),të cilët më patën thënë; Komunistat dhe nacionali-

stat nuk po shkojnë mirë ndër veti. Komunistat janë ba me Rusin, kurse politika ma e mirë është me inglizin dhe për këtë ne jemi ba me inglizin.

-Ne jemi mjaft nacionalist që nuk jemi në qeveri (*unë, Dom Luigj Pici, Riza Dani , Gjergj Kokoshi etj që nuk ua mbaj mend emrat*)më pati thanë Kolë Prela, i cili shtoi se duhet punuar me të gjithë nacionalistët të merremi vesh njeri me tjetrin, si me ata të malit ashtu edhe brenda në qytet me nda ata që janë komunistat sepse duhet krijue tjera Parti.

- Më në fund, më tha, tani duhet të shkosh në Dukagjin, atje të lidheni mirë me popullin, të mbash njerëzit rreth vetit.

-Kur erdha e u takova me Prelë Markun, i cili më pyeti se si është puna, i thashë të gjitha fjalët që më tha Kola, se komunistat dhe nacionalistat janë prishë nder veti dhe ne duhet të punojmë për nacionalistat ashtu siç më ka porisitë Kolë Prela

- Prela më dha fjalën e burrave se do të përpiqet sa të mundet, por shtoi se është mjaft e vështirë se na diktojnë...

Veç kësaj fjalë sekrete unë flisja edhe me Lekë Vuksanin(*Vojvoden*), e Zef Nikën dhe kam bisedue shpesh për çfarë më kishte thanë Kolë Prela.

-Lekë Vuksani (Vojvoda) më pati thanë para tri javëve: Duhet të shkosh në Shkodër e të takohesh me Kolë Prelën, se unë nuk mundem me shkue me e takue dhe ta pyesësh si ashtë politika e si me ba ne tani, njëkohësisht të na biesh një letër prej Kolës.

-Unë nuk shkova në Shkodër se nuk më doli koha pasi ishte e pamundur të mos diktohesha.

-Unë nuk di se çka të them tjetër pasi nuk mbaj mend, por se kam punue kundra kësaj qeverie është ma se e vërtetë, arsyeja ka qënë se mu prish qefi për Kolë Prelën dhe me bindje kam punue si më ka thanë Kola.³

Deklarimi në sallën e gjyqit:

-Unë si anëtar i gjyqit kam qënë 6 muaj pastaj më pushuan dhe shkova tek shtëpia.

Kolë Prela nuk më ka thanë se do të vijë Inglizi.

-Përveç Frontit Demokratik unë tjetër parti nuk di.

-Nuk di se kush i ka hapë parullat, unë di vetëm se kanë dashtë me rrezue Kolë Prelën.

-Unë jam mundue me çdo mënyrë mos me u heqë se ishte njeri i mirë.

-Kolë Prela më ka thanë: Puno e sillu mirë.

-Në shtëpi të Kolë Prelës ka qënë kur u ba një mbledhje e Frontit.

-Me Prelë Çungelin asnjëherë s’jam takue, por me përsone të tjerë që kam përmendë në procesin e mbrojtjes jam takur kur vinin në Kodër Shëngjergjit.

-Nuk kam thanë se në Mirditë filloi lufta dhe as që di se kush i lajmëronte të arratisurit mbi lëvizjet e partizanëve.

-Nuk më ka pëlqye lufta me Greqinë dhe as nuk kam hapë ndonjë parullë të tillë se e njëjta gjë do të ndodhte edhe këtu pasi do ia fillonin çetat e malit psh. Nikë Sokoli, Gjergj Vata, Pal Thani, Pjetër Mehmeti, Mark Tunxhi, Zenun Alija, Muharrem Bajraktari etj

-Unë kam qënë në L.N.Ç dhe nuk kam ba kurrfarë tradhtie, por vetëm kam mbrojtur Kolë Prelën.

- Mbledhje në Pepsuj nuk kam ba as nuk kam qënë, gjithashtu edhe në shtëpinë e Prelë Çungelit të Bobit nuk kam qënë.

-Në Dukagjin kanë qënë shumë njerëz të pakënaqur,por unë nuk i kam mbledhë rreth vetës.

- Thënjët e seksionit i vërtetoj pjesërisht.

NGA VEZHGIMI I HOLLSISHËM I DOSJES GJYQËSORE VËREJMË

Së pari: Gjelosh Lushi kur u përball me përpiluesit e akuzës u bind se sigurimi i shtetit dinte gjithçka rreth aktivitetit të tij anti-komunist, madje ishte e kotë për disa gjëra të përpiquej të mbulonte gjurmët pasi kishte dëshmitar okularë që kishin deponuar të gjitha ato që kishin bërë apo menduar se mund të bënin.

Së dyti Nga ana tjetër Gjelosh Lushi duke qënë tashmë i akuzuar si armik i deklaruar nuk i ra fare mohit se ishte në opozicion me komunistët të cilët i pati aleat vetëm gjatë luftës dhe se me vetëdije ishte instruktuar nga Prof Kolë Prela dhe kishte punuar për opozicionin e ri politik antikomunist.

Së treti Duke qënë se disa nga gjerat deponimi i tij fillestar i mohon në sallën e gjyqit nënkuptohet se ndaj tij si i pandehur me aktakuzën më të rendë të armikut të popullit për rreth 18 muaj është torturuar fizikisht dhe psikologjikisht

Së katërti: Gjelosh Lushi nuk arriti të zbërthehej për pjesën më të rendë të aktakuzës atë të mbledhjes në Karmën e Bobit (*ose shtëpinë e Prelë Çungelit*) dhe në Pepsuj me njerëzit e malit të ashtuquajtur reaksionar.

Së pesti: Gjelosh Lushi, si çdo i pandehur, mundohet të shfajësohet për të lehtësuar sadopak akuzën që i rëndonte, që i hiqte kokën, kur mohon se nuk ka hedhur parulla apo se ka bërë gabim për Kolë Prelën etj.

PRELË MILANI

1 -A.MPB.Dosja nr. 980, fleta .21

2 -A.M.PB.Dosja nr.980, fleta 17

3 AMB.Dosja nr 980-a.fleta 33-35.

Rruga e të rinjve për tek morali



nga Lekë Imeraj

Morali është i vetmi shpëtim, për individin, familjen dhe shoqërinë por, mjerisht, vlerat e tij njerëziteti i kuptojnë shumë vonë ose hiç fare. Filozofët, deri më sot, nuk kanë mundur të arrijnë në një konsensus për përkufizimin e moralit. Mund të mendohet se ky fakt e vështirson të kuptuarit e moralit nga njerëziteti. Ndoshta me moral mund të mendojmë pikpamjet tona, të cilat ne i kemi përfituar dhe përvetsuar gjatë jetës, për veten tonë, të bashkëjetuarit me të tjerët dhe botën si dhe zakonet kulturore të cilat na lidhin me njëri-tjetrin. Nuk është fjala për një gjykim vlerash por, për një kompleks pikpamjesh dhe veprimesh, brënda një kulture të caktuar, të cilat njerëziteti duhet t'i mësojnë.

Ky kompleks fillon tamam në moshën e fëmijërisë së hershme dhe vazhdon, në mënyrë më intensive, gjatë adoleshencës. Zhvillimi i moralit, në këtë moshë, ndikohet nga disa faktorë të jashtëm, mbi të gjitha, nga mjedisi ku rritet fëmia.

Në vitet e para, fëmia, në mënyrë të pavetëdijshme, përvetson ato vlera, sjellje dhe veprime që shikon tek prindët e vet, vëllezëria, fëmijët e tjerë, edukatorët dhe mësuesët. Mos harrojmë gjyshin dhe gjyshen të cilët luajnë një rol shumë të madh në formimin e fëmijëve. Në moshën katër vjeç, kur aftësohet për të lidhur me

të tjerët, fëmia krijon ligjin e vet fondamental: Si ti mua, edhe unë ty. Nuk të le gjë mangut. Me përvojën e të dëgjuarit dhe ndëshkimit, në moshën katër deri në gjashtë vjeç, krijohet aftësia diferencuese mbi të mirën dhe të keqen. Në këtë fazë ata tregojnë interes për përrallat të cilat tregojnë njeriun e mirë dhe të keq, në variante të ndryshme. Për fëmijët, sjelljet e mira dhe të këqia të personazheve të përrallave nuk janë abstrakte por konkrete, të paktën kështu i mendojnë ata. Fëmia i lidhë ato me përvojën e vet, të cilën e përjeton gjatë kohës me njerëzitetin e tjerë, me sjelljet, veprimet dhe qëndrimet e tyre.

Pikpamjet bardh e zi mbi të mirën dhe të keqen, që i shikojnë tek të tjerët, sqarohen vazhdimisht gjatë viteve në vazhdim.

Në mitologjinë greke, perenditë dhe perendeshat, heronjtë dhe heroinat, personifikojnë vlera të veçanta si diturinë, urtësinë, drejtësinë, ose dashurinë e nënës por, njëkohësisht, edhe xhelozinë, urrejtjen dhe hakmarrjen.

Sot, të rinjtë, nuk lexojnë më libra nga mitologjia greke, atëherë nga i mësojnë këto gjëra!? Duket sikur i shtynë shkolla për një gjë të tillë. Ata sot vrapojnë pas Harry Potter ose personazheve të tillë. Edhe tek Harry Potter bëhet fjalë për drejtësi, besnikëri dhe tradhëti, falje dhe hakmarrje, fitore dhe humbje, jetë dhe vdekje. Figurat vërtetë janë ndryshe por, vlerat dhe përmbajtja janë e njëjtë, tamam si ato të mitologjisë greke. Megjithatë sot, fëmijët tonë jetojnë në një kulturë krjet tjetër, personazhet e mitologjisë influencojnë shumë në formimin e tyre. Sa tërheqëse mbeten keto legjenda për njeriun e të gjitha kohërave, e vërteton fakti i prodhimit të filmave të panumurt, programeve televizive dhe revistave me të tilla përmbajtje.

Në moshën dhjetëvjeçare, fëmia formon idetë morale për njerëzitetin, sjelljet dhe fatin. Me zhvillimin e përfytyrimeve mbi strukturat sociale, fillon të kuptojë ligjin dhe shtetin, baza e moralit për të drejtën dhe rregullin. Fëmia i përvetson rregullat të cilat i zbatojnë njerëzitetin në mjedisin ku ai jeton. Në fazën e pubertetit zhvil-

lohet tek ata një moral universal, të paktën për ato rregulla të cilat i njohin gjithë qytetarët e botës.

Por, cili moral, duhet të jetë morali i tyre!?

Çdo gjeneratë e ndërton moralin e vet mbi një bazë të re. Morali i paraardhësve nuk mund të jetë kurrë edhe morali i pasardhësve. Ndryshej do të mohonim zhvillimin. Është detyra e çdo gjenerate "reformimi" i moralit gjë të cilën mund ta bëjnë vetëm të rinjtë. Si shembull mund të përemndim kryengritjet masive në shtetet veriore të Afrikës në dhjetëvjeçarin e parë të këtij shekulli ku heronjtë kryesor ishin të rinjtë. Ata kanë besimin dhe shpresën, kurajon dhe guximin për ndryshim, për çlirimin e shoqërisë nga dhuna dhe korrupsioni. I tillë ishte edhe revolucioni në Europën qendrore dhe lindore në vitin 1989. Në çdo gjeneratë dhe vend ka njerëz që luftojnë për të drejtat e njeriut. Edhe në Kinë, në vendin e diktaturës së ashpër, në vitin 1989, të rinjtë u ngritën në sheshin Tiananmen, për të demonstruar paqësisht por, mjerisht, shumë prej tyre e paguan guximin me jetën.

Të rinjtë janë bërthama e moralit shoqëror. Nëse do të pranojmë se, të rinjtë e sotshëm, nuk i njohin vlerat e së drejtës, vëllazërimit, lirisë, demokracisë, do të gabonim. Mendoj se të rinjtë, janë shumë më të interesuar për këto vlera, se sa mendojmë ne. Në të gjitha kohërat të rinjtë kanë qënë të imteresuar për moral dhe etikë. Por, vetëm atëherë, kur aty shikojnë interesat e tyre jetësore.

Në kokat e të rinjve janë mbërthyer shumë pyetje përgjigjen e të cilave duan ta mesojnë psh: Çfarë guxon dhe çfarë nuk guxon njeriu? Ku mbaron liria e tjetrit? Përse, të gjitha rregullat e arta, gjenden në çdo kulturë dhe religjion? Përse njeriu, në të gjitha kohërat, kulturat dhe religjionet, e ka menduar moralin si kusht i bashkekzistencës?

Të rinjtë janë shumë të ndjeshëm dhe të gatshëm për të diskutuar mbi tema të tilla. Por, jo tek të gjithë. Kërkimet mbi zhvillimin e moralit, kanë treguar se, jo

të gjithë të rinjtë, ashtu si dhe të rriturit, janë të gatshëm të diskutojnë dhe mesojnë rregullat e arta të moralit. Sipas psikologut L. Kohlberg, vetëm një pakicë e të rriturve është e orientuar për një etikë universale. Shumica mbështetë një moral i cili siguron rregull dhe drejtësi, moralin e kulturës së vet kombëtare. Të tjerë, grupe dhe sekte të ndryshme, interesohen vetëm për moralin e tyre tradicional, duke përjashtuar çdo moral tjetër.

Si mund ta kuptojnë fëmijët thelbin e moralit shoqëror, të drejtat dhe rregullin?

Ky është problemi më i mprehtë, për familjen, shkollën dhe shoqërinë. I gjithë mendimi psikologjik është në unanimitet se fëmijët janë shumë më tepër imitues se sa dëgjues. Fëmia e fillon përvojën e tij të parë në familje, me prindët dhe vëllezërin e tij, pastaj me fëmijë të tjerë, nëse merret vesh me ata, nëse i pranon rregullat dhe ritet e tyre. Në familje fëmia mëson të marrë vendime ashtu siç shikon tek prindët e vet. Ata i imitojnë prindët e vet, që nga të ecurit, gjestika, qëndrimi në tavolinë, komunikimi me njëri-tjetrin, grindjet, mënyra e zgjidhjes së konflikteve. Këtë proces imitimi, psikologët e mendojnë procesi i socializimit. Ky proces është aq i pushtetshëm tek fëmijët sa, pranojnë edhe ndëshkimin nëse dikush i detryon të sillen në kundërshtim me atë që kanë mësuar nga prindët e tyre. Në mardhënjë prind-fëmijë, rreziku më i madh qëndron në faktin se, prindët mundohen me çdo kusht që të edukojnë tek fëmijët e tyre atë që kanë trashëguar nga prindët e tyre. Të mirën dhe të keqen, të vërtetën dhe të gabuarën, t'i mendojnë dhe klasifikojnë si ata. Pra, gjeneratë pas gjenerate të trashëgohet i njëjti moral. Ky është gabim fatal. Me kalimin e kohës, fëmia shkëputet nga të rriturit, në të mësuarit e rregullave dhe lidhet me moshën e vet. Aty fëmia mëson se guxon të luaj me të tjerët vetëm nëse zbaton rregullat e grupit. Fëmia nxënës shkollor, mëson rregullin dhe gradualisht e kupton atë, rëndësinë e tij. Aty kupton dhe është në gjendje të bëjë diferencimin mbi atë që duhet dhe që nuk duhet, mbi të veten dhe të tjetrit.

poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi ***

Për liri do të bëhem fli
"Brenda në kafaz!
Mizori!
Hamë hamë hamë
Për liri
Do të bëhem fli!"
A të kujtohet
Kur kemi luajtur bashkë
Ma gjoks e bark jashtë
Atje te mullari i sanës
Nën dritën e Hënës?
Stop...
Mbani distancë
S'ka ma spirancë!
Vezullimet e vesës
Në lulet e pjeshkës
Ujëvara të shpresës.
Grumbullimi i reve
Në qiellin e kaltër
Sinjalizon kohë të vranët.

Kur isha i vogël
Nëna shpesh më lutej:
"Haje more bir!
Gjella asht e mirë!"
Atëherë ishte pranverë
Ishallah po thotë edhe një herë!
Një natë në ëndërr!
Dekameroni dora vet :
" Mos harro Rrëfenjën e dhjetë".
Një zog i vogël
Në një degë të plepit
Diçka i thotë vetit
Rrinë e mendon!
Për jetën e tij mediton!

Ekliptit të Diellit Shkurt 1961
Mëngies plot shkëlqim
Murrllani frynte me tërbim
Kompania gati për marshim
Oh, ç'na gjeti!

Erdhi kiameti!
Pa dritën e Diellit
Si do jetoj planeti?!
Në fund të korrikut
Në maje të një fikut
Te një degë e vjetër
Kokrrat ma të mira
I zgjodhi për vete!

Zonjushë...
Kam dy fjalë ...
"Shih majën e bërrylit djalë ...
Dëgjoni, tha Prenda:
"Botën anë e mbanë
E sundon femra...!"
U tha pusi!
S'ka ma ujë!
I ka bërë nderë gjithkujt!
I mblodha në male
Në kopshte, pyje e livadhe

Por as njëra nga ato
Nuk e ka aromën tënde!
Po vij në patat
Tujë u përkund
Njëra pas tjetrës
Mos vallë erdhën plakat?!

Dy trumcakë
Në maje të një murit
Afër çezmës së ujit.
Kujdes Uratë!
Errësirë e madhe....
Natë...
Rruga me ujë, ferra e baltë
Veladonin
E ke shumë të gjatë!
Letër nga Pekini:
"E shtrenjta grua
Po tretëm, medet
Larg teje tash sa vjet

I vetëm dhe i shkretë
Një vajzë kineze
Rrugën ma ka zanë
Asht e bukur si Hanë
Punëtore me fletë
Si ajo ku me e gjetë?
Më jep miratimin
Perëndia të dhuroftë shpërblimin!
Një mëz tan shend e verë
Nën barkun e nënës së vet pelë:
"Jam ende i mitur!
Qumësht jam duke thithur!"
I janar, Borë e parë
Tarabosh qindra mijëra vjeçar
E gëzofsh kostumin e bardhë!

Luigj Temali

FREDERIK RRESHPJA: “KËNDOJ PËR ATA QË IKËN...”

In Memoriam/ I lënë në harresë nga vetja dhe nga të tjerët, ai thërret nga thellësia e shpirtit, se nuk don që të pikëllohet kush për fatin e tij, dhe se, ka ardhur ora që ai të vdesë përsëri... Ky ishte qytetari Frederik Rreshpja, i cili u nda nesh për t'u kthyer në jetën e përjetshme në Shkurtin e vitit 2006

Duket, për fat të keq, se nuk ka ende kurrgjë të re, sa i përket fatit të poetëve të njimendte shqiptarë; qysh në lindje, “fatitë injorante” që u këndojnë mbi krye, u përziejnë të njëjtën lëndë të zezë të dhimbjes së pambarim, e të vetë Pambarimit, duke i shndërruar në Diej, e Diejt nuk kanë varr, nuk lindin për të zbritur në tokë, por për ta shndërruar Tokën, e nëse u duhet të rrinë në tokë për do ditë, veçse vuajnë...

Rrugëve, i ngarkuar me shtrigninë mrekulluese të artit që fshihte brenda vetes, ecte, lëkundej, endej, dhe donte që askush të mos pikëllohej për fatin e tij. Dhe kjo ishte dëshira e një njeriu i cili nuk e di nëse kishte mbetur ndonjë gjë në botë që ta gëzonte... Këto janë fjalët e tij. Këto janë fjalët e një njeriu që bota e mbyti. E ashtu siç thotë Pol Elyari, “le ta pyesim nëse ai luftoi, para se bota ta mbyste...”

I lindur në Shkodër, në zemrën më pulsuese, më të përgjakur e më të goditur të poezisë e kulturës shqiptare në përgjithësi, në vetë thelbin tragjik të poezisë shqipe e të jetës shqiptare, Frederik Rreshpja do ta ndjente praninë e kësaj fryme “mallkuese” që në fëmijërinë e hershme; do t'i blatohej poezisë si askush tjetër, e deri në orën e mbrame te gjallimit.

Rëndesa e kohës duket se ia vështirësonte përpjekjen për ta hapur përfundimisht e plotësisht gurin e çmueshëm ku ai ruante artin. Ndoshta ishte poeti i parë demokrat i këtij vendi...?! Lirikat e tij e tejkalojnë kohën. Lirikat e tij e bëjnë të huaj kohën. Ai i bënte shteg rrugës së vet. Kjo rrugë, që në të vërtetë ishte rruga e rinisë shkodrane, binte ndesh me mjedisin vdekjeprurës që po sajonte “qeverisja” e kohës. Vargjet ishin zjarri i shpirtit dhe thellësia e ndjenjave, që gjithësi përplaseshin me shterpësinë dhe hipokrizinë e asaj politike. Kjo ndeshje ndodhte brenda vetë poetit. Këtë ndeshje të tjerët nuk arrinin ta shihnin. Ata shihnin veçem Frederikun të zhytur në një botë të turbullt, tek notonte në tymnajën nga ku gjallonte arti, si një diell ëmbëlsisht i vuajtur që lëshonte

rrezet e një pikëllimi hyjnor. Kjo gjë ia stuhiste shpirtin, prandaj ai ishte shndërruar në një bohem të vërtetë, në një plangprishës të madh të vetvetes,



nihilist për mjedisin dhe të tjerët, por gjithmonë, dhimbshurisht i dashur.

Në fundin e jetës ai thoshte se çdo gjë e kishte humbur në mënyrë serioze, dhe nuk ankohej për këtë fat. Dhe shtonte se, kur trishtohet, shkruan... Ia kishte gjetur që në krye të herës vetes barin kundër të ligës, barin dhe trumzën e butë...

Poezitë e tij te para ishin ndryshe nga poezia që koha po gjymtonte. Ato përshkoheshin nga një pezëm që ngjante me një thirrje për të shpëtuar artin e vërtetë që po shpërbëhej, thirrje, për të shpëtuar vetë shpirtin nga bjerrja.

Kjo gjë e bën atë, tashmë pa asnjë dyshim, poetin e parë demokrat.

Sigurisht, e priste burgu. Filloi një jetë tjetër, që në fakt ishte tmerri dhe çnjerëzimi me emrin Spaç. U dënua dhe u ridënua...

Diktatura dukej sikur vdiq, por në të vërtetë, për Frederik Rreshpen ajo vetëm u rrëzua. U përbiruan muret e saj nga ku fluturoi edhe ky shpend i ngujuar.

Kishte shumë ëndrra të ruajtura, e tashmë dukej se, edhe mundësi për t'i jetuar. Deshi të fluturonte diku lart,

por ishte e pamundur, mungonte oksigjeni, prandaj krahëthyer ra në tokë nga ku u ngrit përsëri, poeti bohem Frederik Rreshpja, me rrobat e vjetra,

marramendëse, e me tej, në një livadh hyjnor ku merr jetë gjithçka njerëzore. Të duket se duke folur për Frederikun poet, i cënon të drejtën të tjerëve që ta shijojnë poezinë e tij. Në të vërtetë ai nuk kishte e as nuk ka nevojë për vleresime të tipit, “i madhi”, “i mrekullueshmi”, “i paarritshmi”, “i papërsëritshmi”, “gjeniu”, e për hir të së vërtetës, ai i ka të gjitha këto, por më së pari, dhe çka është më e rëndësishmja, ai është Poeti.

Ai shkroi gjithë jetën e tij pa kërkuar kurrgjë. Në të vërtetë kjo ishte kërkesa e tij e vetme, t'i jepej fjalëve e të ikte me to... e me to na bëri të ndjehemi aq të mirë e gjallë, gjallë prej fjalësh e ndjesish të jashtëzakonshme e të vërteta gjer në dhimbje. Ai nuk mundi të na japë gjë tjetër përpos vetes, dhe këtë e ofronte pa pikën e dyshimit e të pendimit, deri në fir... Dhe tani ndodhet diku lart dhe larg, prej nga nuk mund të ikë më, sepse Ai vetëm ikte, nga kasolija, nga dritat e rrejtshme, nga Shkodra, nga Tirana, nga spitalet, hotelet, azilet, ikte nga dashuritë, nga vetja, e përfundimisht, edhe nga toka... Dhe ai përsëri nuk kërkon asgjë prej nesh, ndërkohë që na e ka dorëzuar krejt zërin, ngjyrat, aromat, vegimet e shpirtit të tij. Është tash nevoja jonë, ndërgjegjia jonë e dërrmuar që na nxit ta afrojmë më afër nesh, më afër atyre që e duan dhe e respektojnë përdritjen e artit, më afër të rinjve që duhet të dinë se si mund të kalosh nëpër të ardhmen, e mbi të gjitha, më afër atyre që duan dhe çmojnë më shumë se asgjë, lirinë.

Vdekja e ndeshi Rreshpen për ta ngulitur përfundimisht brenda nesh. Tashmë, atje ku ka shkuar, Ai nuk është më Vetëm.

Ndjesë pastë Miku ynë, gjithnjë i Përrjashtuar, gjithnjë Humbës, gjithnjë i Mashtruar, e Zoti na ndjeftë ne, që duam të pastrojmë ndërgjegjet tona duke u përpjekur t'i japim atë çka Ai njeri që ishte Humbëtira e Vetes, duhet ta kishte qysh në të gjallë, gjithnjë.

Por, çka është gjallimi, në mos humbëtitirë për njerëzit që u “rëndon” shpirti,

e veç enden nëpër ajri...!

Nga Ledia Dushi

Frika dhe pasiguria e shtegtarit Dante, përpara se të fillojë udhëtimin në botën e përtejme

Kanga e dytë, që fillon me thirrjen në ndihmë të muzave dhe përcaktimin e argumentit për trajtim (v.1-19), asht si një prolog i dytë, por i kushtuem hymjes në Ferr, dhe shtjellon një temë të dytë qendrore dhe përgatitore të poemës.

Si kemi lanë mbrapa skenën sim-bolike, ku zhvillohet *udhëtimin e kësaj jetë*, tani gjendemi në një breg të errët, në një orë të shtyme, përmes të cilës muzgu i mbramjes paralajmëron një botë pa dritë, në të cilën po përgatitemi të hyjmë. E kështu, shtegtarit, krejtësisht i vetëm përballë vujtunisë që e pret, provon një frikë tjetër dhe ndeshet me një pengesë të re. Si e pse, me çfarë forcash do të mundet ai vallë të përballojë një mision të tillë? Kjo frikë e brendshme dhe e thellë, që reflektohet me pyetjen e ankthshme (v.31), dhe përgjigjia e mrekullueshme që merr, pikërisht për ndërhyrjen dashamirëse qiellore për të kompensue pamjaftueshmëninë e tij, përbajnë krejt argumentin e kangës. Dante shpalosë këtu - mbështjellë me një përfigurim dramatik - vetë arsyen që e ka shtye të ngjizë poemën, udhëtimi i paracaktuem nga providenca hyjnore, çka përban argumentin e një randësie kapitale. Farca poetike, që shpërthen prej dy figurave të kësaj kange - njeriu pre e përhumbjes dhe vetëdija e të mosqenit i denjë nën atë qiell të zi e në atë breg të errët, dhe grueja *me sy që i ndritnin*, që vjen në ndihmë të tij prej qiellit, e dërgueme prej së nalti e që ka marrë mundimin shtye nga forca e dashunisë - asht një prej atyne që bazohet mbi një përvojë të gjatë jetësore.

Problemi që shtrohet këtu përban themelin e vetë shtegtimin (pra të vetë poemës): si ka mundësi që një vdekatar i thjeshtë, e për ma tepër mëkatar, të jetë i denjë për një ndërmarrje kësisoj, ngarkue burrave të tillë, si Enea e Pali, që patën mision të përtëritnin në shoqinë njerëzore rendin politik dhe atë fetar? Dante, që të krahasohet ndopak me ta, nuk ka asnjë shans, dhe kurr - as këtu e askund në Komedi - nuk na shfaqet asnjëherë ndonjë pretendim që ta meritonte me e marrë përsipër këtë mision. Përgjigjia e Virgjilit konstatimit të Dantes (*për t'illë as unë e askush nderue s'më ka*) nuk asht për të shpallë - dhe kjo asht ma e forta - që Dante të jetë në njëfarë mënyre i denjë, por për të tregue se *dikush* ka ndërhye në favor të tij për shkak të dashunisë (*dashnia m'shtyu të vij me t'kuvendue*), e cila shtyhet e frymëzohet nga mëshira hyjnore: *Trazue një grue*

e fisme asht jo pak... Mirënjohja ndaj ndaj një ndërhyrjeje të tillë asht e dukshme, themelue në një të vërtetë të thellë teologjike. Por asaj i përkon një realitet që dallohet qartë në jetën e Dantes. Në fakt duket se Dante përpiqet t'i vendosë një titull kësaj ndërhyrjeje të jashtëzakonshme. Ashtu ka veprue me Virgjilin (*dobi po m'sjell dashnia e pamatë, për me studiue gjithë veprën tande t'vlerë*), kështu ka veprue edhe me Beatricën (*pse s'i je gjetë atij që t'don aq shumë*): ky titull që ka gjetë duket se asht e gjithë *dashnia e tij*.

Ato realitete pra, që kanë tërheqë dhe udhëheqë jetën e tij, që nga rinia, janë po të njajtat edhe sot, dhe me të drejtë i vijmë prej qielli në ndihmë dhe e shpëtojmë. Fuqia e madhe e përvojës personale, çka vërehet në të gjithë kangën - gja që të sjell ndër mend shumëkahshëm e gjithëherë

E gjithë kanga asht ndërtue në mënyrë të tillë që vendi i errët, ku ndodhen Dante e Virgjili - dhe ku zhvillohet drama e frikës së Dantes - të shërbejë si kornizë qendrore për shfaqjen e Beatricës, si dhe sfond qiellor prej ku ajo zbret. Frika largohet menjëherë sapo shfaqet ajo dhe duket sikur sjell me vete kujtimin e pashlyeshëm të një kohe tjetër të jetës: huzimet e qarta nga *Vita Nuova* nuk janë në fakt kujtime të një poezie ende e papjekun mirë, por thirrja e vetëdijshme e asaj kohe rinore në të cilën Dante ndiqte besnikërisht udhën që i tregonte zemra (shih Purgatori K.XXX, v.122-123) e që tani falë saj - pra, drejtue prej të njajtës frymëzuese - gjen *rrugën e humbun*.

Por, përveç kësaj historie themelore, që zotnon gjithë kangën, shkëndijon, lehtë por pangatërrueshëm, funksioni publik solemn që Dante merr mbi vete. Dy

fillimet e veta - dy realitete themelue e vendosë nga Perëndia për të rregullue jetën e njeriut mbi tokë - sigurisht që edhe ky udhëtim i tretë (udhëtimi i Dantes në Përtej) do të jetë në njëfarë mënyre shtojcë e këtyne dy realiteteve. Gja ma shumë këtu nuk thuhet, por kaq mjafton për të intonue Komedinë në regjistrin epik, që aq shumë i përshtatet dhe që e distancon në mënyrë të qartë nga çdo krijim tjetër me karakter gjithsesi privat. Në mënyrë të ngjashme, në fund të fundit, ashtu si Dante nuk shtyhet të shkojë atje (në Përtej) nga vetvetja, por për hir të të gjithëve ne, ashtu edhe Beatrice, nuk shtyhet prej vetvetes me ndihmë Dante, por asht e dërgueme prej së Nalti: dhe faktikisht Virgjënësia Marie - të cilës nuk i përmendet emni, por që bahet e dallueshme veçse tue kujtue mëshirën e saj - zen vendin ma të naltë të kësaj kange.

Janë këto shenja - emnat nga ma të famshmit në tokë e në qiell, që në këtë kangë meritueshëm kanë zanë vendin e vet - që karakterizojnë, në unicitetin e vet, *Komedinë Hyjnore*, e cila synon të përfshijë, siç vetë autori i saj na thotë në fund (shih Parajsja K.XXXV, v.1-2), tanësisht historinë, qiellore e tokësore së bashku, çka e gjitha rrëfëhet me një natyrshmëni, ashtu siç rrëfëhet takimi me një shok. Por trajektorja e kangës mbyllet - tue ndjekë një rregullsi të brendshme, si të ishte një harkore e përsosun, që lexuesi mësohet shumë shpejt ta dallojë - dhe ulet nga ato farë naltësisish, pra të historisë dhe të teologjisë, në një prej ma të thjeshtave e të zakonshmeve imazhe që syni i njeriut mund të soditë: në të mahnitshmen shëmbëlltjërë të lules së mëngjesit, çka besojmë se u ka ba përshtypje të gjithëve, që përmbyll kangën e që në fakt riepilogon, me dukjen e saj të brizhtë, të gjithë atë ndodhi të randësishme naltpërmendun: frika e njeriut me forca të pakta (*kështu më ngjau me forcën time t'mpakë*) dhe ngushëllimi që vjen prej Perëndisë dhe që e forcon. Kështu, asht e pamundun me

veçue - në këtë vend të ngushtë, por kaq të thellë - bukurinë përmendit të Beatricës, apo të këtij imazhi të fundit, nga tanësia e kangës. Kjo bukuri qiellore i rri përballë asaj frike të errët, të cilën e shndërron në trimni të zjarrtë; dhe ky ballafaqim shpreh, në sekuenzen e vet të përsosun, ndryshimin e thellë dhe të menjëhershëm të njeriut dhe të mënyrës së tij të të menduemit, çka e gjithë kanga përpiqet të tregojë.



poezitë e kohës së *Vita Nuova*, që këtu përtërihen me gjithë magjinë e hershme, madje me një forcë edhe ma të madhe - asht shembulli i parë i artit të pazakontë dantesk dyregjistrash, të cilin pashmangshmënisht do ta ndeshim shpesh, ku rrugët e Firences do të ndërthuren me rrugët e qiellit, ku gjuha e Isaias do të gjejë pasqyrim në vulgun toskan dhe ku Enea e Pali do t'i bajnë kontrafigurë poetit të *Vita Nuova*-s.

emnat emblematikë të Eneas e të Paolos, ndërmarrjen e të cilëve ai e përmend, i japin qysh prej fillimit një dimension historik dhe qytetar kësaj ngjarjeje me qëllim shpëtues, duke parashtreue edhe simbolikën e dytë që i përngjitet këtij udhëtimi. Nëse njeni (udhëtimi i Eneas në Përtej) kishte për detyrë të parapërgatiste rrugën për themelimin e Perandorisë së Romës, dhe tjetri (udhëtimi i Pali në Përtej) të japë garanci për besimin e krishtenë në

30 Aty, mandej, e Zgjedhna Kupë ka shkue,
për atë besim të garantojë çdo gjë,
që për të gjithë asht rruga me shpëtue.¹⁰
Po unë, pse t'vij, lejim vallë kush u bëtë!
Nuk jam Enea, as Pali gjithashtu;
33 për t'fillë as unë e askush nderue s'më ka.¹¹

të tij fitore - Bahet fjalë për fitoret korë mbi kundërshtarët vendas latinë.
t'papës veladon - Veladoni apo manteli që mban papa, si simbol i papatit, asht përdorë edhe herë të tjera në Komedi: "kam pasë mantelin përnderues" (K.XIX, v.69).

Ky fragment (nga v.16-24), ku qartazi na shpaloset mendimi i poetit se sundimi i Kishës në jetën ekonomike e politike asht mjete që Perëndia të administrojë të gjitha aspektet e jetës së njeriut, përban rastin ku ma mirë se askund tjetër Dante na shfaqet si një guelf i vërtetë. Guelfët dhe Gibelinët janë dy fraksione që kanë dominue skenën politike italiane të shek.XII, deri në lindjen e Zotnimeve, në shek.XIII. Në konfliktin mes papatit dhe perandorit, apo pushtetit komunal, simbas rastit, guelfët mbështetnin papën dhe gibelinët perandorin, apo pavarësinë e komunave nga papati. Qëndrimi i këtyne të fundit, konsiderohej nga guelfët si heretik. Jo rastësisht Dante, përgjatë Kantikut, shprehet pikërisht kështu për ta, edhe se mes tynë ka njerëz të shquem, si Farinata, për të cilin na shfaq një respekt të veçantë. Asht tepër e ngutshme me u shprehë se gibelinët ishin për ndarjen e pushtetit të Kishës nga pushteti temporal. Ide të tilla do të vinin natyrshëm në rrethana krejt tjera në shekujt e mavonshëm. Rreshtimi përkrah papës i guelfëve apo kundër i gibelinëve, ka të bajë pastërtisht me interesa politike, të cilat motivoheshin nga interesa ekonomike.

Duke u kthye tek poeti, asht për t'u theksue se ai, edhe se guelf, pra një mbështetës i padiskutueshëm i pushtetit papnor, aspak nuk ban kompromis me individë të cilët abuzojnë me këtë pozitë të naltë dhe hyjnore, simbas tij, por i dërgon pa hezitim në Ferr, siç do të kemi rast të shonim.

Ma gjatë e detajuem për situatën politike, jo vetëm të Firencës, por të gjithë gadishullit, do të flasim në shënimet e Kangës VI.

10 Aty - Në botën e pëtejme e, në rastin e Palit, në Parajsë. Pali, në Letrën II drejtue Korintasve 12:2-4, thotë se asht ngritë nga Perëndia deri në qiellin e tretë: "Unë njoh një njeri në Krishtin, i cili, para katërmëdhjetë vjetësh (a ishte në trup, a ishte jashtë trupit, nuk e di; Perëndia e di), u rrembye gjer në të tretin qiell. Dhe e di se ai njeri (a me trupin ose pa trupin, nuk e di, Perëndia e di), u rrembye në parajsë dhe dëgjoi fjalë të patregueshme, që nuk është e lejuar të thuhet nga njeri". Në Mesjetë, tue u keqkuptue pikërisht këto vargje, u krijue legjenda se Pali ka shkue në Ferr, për një mision të veçantë, gjë për të cilën në Beslidhjen e Re nuk kemi asnjë informacion. Në kurthën e këtij interpretimi bien edhe shumë komentues të hershëm.

e Zgjedhna Kupë - Në original: *Vas d'elezione*. Vas / vasello - vazo, kupë, enë ku ruhet diçka për përdorim. Në këtë rast flitet për Palin, që Dante e përmend edhe në *Parajsë* tue e quejtë *Kupa e Shpirtit të Shenjtë*. Këtë përcaktim Dante e merr nga Bibla, libri *Vepreat e Apostujve* 9:15 ku Zoti thotë për Palin: "ai është vegla që unë kam zgjedhur për të mbajtur emrin tim përpara kombeve, mbretërve dhe bijve të Izraelit". Në tekstin biblik greqisht, termit shqip *vegël*, i korrespondon termi *skeub-* (*skeuos*), që do të thotë *vazo, enë*, e në një kuptim ma të përgjithshëm *vegël, instrument*. Vulgata latine, në të cilën duhet të jetë bazue Dante, e jep: *vas electionis est*.

të garantojë - Në referim të asaj që Pali ka shkruie (u rrembye në parajsë dhe dëgjoi fjalë të patregueshme, që nuk është e lejueshme të thuhet nga njeri), Dante thotë se Pali në këtë udhëtim ka marrë informacion të matëshëm në lidhje me besimin e krishtenë, çka ka shërbye të forcojë besimin në Krishtin, por gjithashtu, përmes predikimeve të tij mandej, asht ba inkurajim për të gjithë komunitetin e krishtenë. Tue rreshtue Palin përkrah Eneas, Dante na kujton se dy burimet kryesore të frymëzimit të tij janë tradita letrare klasike dhe shkrimet e biblike.

rruga me shpëtue - "Pa besue në Krishtin s'asht e mundun me shpëtue, pavarësisht se me sa virtut asht i mbrujtun njeriu. Me shpëtue duhet ai besim që, i pashoqnuem njëkohësisht me vepra, asht i vdekun" (Benvenuti, f.75).

11 Po unë, pse... - Kjo pyetje dramatike nxjerr në pah gjithë dyshimin, pas një parashtrimit të gjatë (v.10-30). Enea e Pali kishin një mision me krye, prej të cilit do përfitonte i gjithë njerëzimi. Po Dante ç'mision ka?! E, meqenëse nuk ka mision, kush e lejon udhëtimin e tij në botën e pëtejme?! Në fakt, këto dy pyetje, edhe se ba prej Dantes me paditë një absurd, parathonë se realisht ai e ka një mision për të cilin ende nuk asht i vetëdijshëm. Vetëm në Parajsë do të kthellohet plotësisht për këtë. Mesazhi që na vjen nga poeti, asht se edhe pa qenë një Enea apo një Pal, me anë të Hirit të Perëndisë, një njeri i thjeshtë dhe

36 Se, po të nisem për me rrugëtue,
druë marrëzi del fundi i udhëtimit.
Je i urtë, kupton dhe çka s'di me e spjegue».¹²
Sikurse një q' heq dorë prej dëshirimit,
ma imtë shqyrton e mendjes i ban kthesë,
39 qëndrimin tuj ndryshue nga i fillmit,¹³
kështu më ndodhi në bregore t'zezë
se, tuj mendue ma thellë, e pata fikë
shkëndinë prej t'cilës në fillim qeshë ndezë.¹⁴
«N'se filli i kumtit tand nuk më ka ikë,
- gjegj hija atij të dëji për lavdim, -
45 ligshue asht shpirti yt nga e madhja frikë;¹⁵

një i krishtenë i përlun, mund të përvojë udhëtimin e vështirë drejt pendimit dhe shpëtimit.

Nuk jam Enea, as Pali gjithashtu - Varg që shpreh mëdyshjen ma të madhe që Dante kalon në këtë çast. Këta dy emna, jo më kot evitue të përmenden ma parë, por veç në mënyrë të perifrazueme (Enea - *ati i Silvit* v.13 / Pali - *Kupa e Zgjedhur*, v.28), tani marrin vlerën e meritue tue u sjellë këtu me gjithë historinë e tynë providenciale, sepse secili asht pikë referimi për botën e vet: Enea në atë pagane, që kulmoi me Perandorinë Romake; Pali në atë të krishtenë, që kulmoi me pushtetin e Kishës. Përballë tynë gjendet një i krishtenë i thjeshtë, mëkatar, përfaqësue nga Dante personazh, që, për arsyt që thamë ma nalt, i asht dhanë mundësia e këtij udhëtimi.

12 marrëzi - Dante frigohet që të mos kalojë masën. *Marrëzi* asht i njaji përcaktor që poeti përdor dy herë për të emnuë ndërmarrjen e Uliksin (K.XXVI, v.125 dhe Parajsë XXVII, v.83), çka, edhe se shty nga qëllime fisnike, i ka kushtue jetën. Gjithashtu ka edhe një përkim tjetër në përdorimin e termave: udhëtimin e vet në botën e pëtejme dhe atë të Uliksit e quen *alto passo*, që ne, për arsye semantike, i kemi sjellë me *shteg t'naltë e të vështirë* (K.II, v.142 dhe K.XXVI, v.132). Në lidhje me përfaqsimin e figurës së Dantes personazh dhe të Uliksit do të kemi mundësi të flasim ma gjanë në kohën e duhur (Kanga XXVI).

13 Sikurse një... - Mes pyetjes së Dantes dhe përgjigjes ngushëlluese të Virgjilit, kjo shëmbëlltyrë paraqet gjendjen e brendshme të protagonistit, çka përban një proces psikologjik prej të gjithëve përvojue. Me heqë dorë prej asaj që dëshiron, asht tipike e dobësisë së njeriut. Dante na e shfaq dobësinë e tij me këtë shëmbëlltyrë, që pasqyron ma së miri mëdyshjet, ndërsa gatitet të përballtet me barrët e këtij udhëtimi, që janë si fizike, ashtu edhe shpirtnore.

14 në bregore t'zezë - Kujtojmë se Dante e Virgjili janë ende në zallishjen e shkretët, diku mes pyllit dhe kodrës. Bregorja asht e zezë, jo vetëm sepse ka ra nata, por një peisazh i tillë, i errët, i paqartë, mëdyshas, pasqyron gjendjen e vetë protagonistit.

shkëndinë prej t'cilës në fillim qeshë ndezë - Kujtojmë se në fundin e Kangës I (v.112), sapo Virgjili i ka sugjerue që një tjetër shteg me marrë: as me u kthye mbropa (në mëkat) as me ba përpara drejt kodrës (për shkak se asht në mëkat), por një të tretë, që asht i mundimshëm po, por që çon në njohjen e pasojës së mëkatit. Dante asht tregue shumë entuziast për një shtegim të tillë (*Poet, të jam i përgjërue, ... m'dërgo... që të mund të shoh... / v.130-135*), entuziazëm që kulmon në vargun e fundit të kangës: "E, si lëviz, mbropa i shkova mjeshtrii" (v.136). Por, mbasi veç pak hapa ka ba, asht kujtue se në *Përtej* shkohet me një mision të veçantë, çka nuk i rezulton të ketë me përmbushë. Kjo përsiatje (v.10-33) e çon atë që të bajë asgjë të gjithë dëshirën e zjarrtë me i hy kësj aventure.

15 N'se... frikë - Këtu Virgjili, sapo hapë gojën me folë së pari, godet drejtpërdrejt në thelbin e problemit, tue shpallë se dyshimi dhe ngurrimi i Dantes asht shkaktue nga frika, e cila shpesh pengon njeriun nga një ndërmarrje fisnike. Nga ana e vet, Dante asht mundue t'i paraqesë Virgjilit disa arsye pse ky udhëtim i duket absurd (*nuk jam Enea e as Pali*). Por Virgjili, tue njohë mirë natyrën njerëzore (*o dijetar me za*, K.I, v.89), e kupton menjëherë se cila asht arsyeja e vërtetë e ngurrimit të Dantes. Për këtë, pa u matë aspak, i thotë atij shkakun e ngurrimit, që asht frika. Në zhvillimin e këtij Kantiku do vemë re shpesh se Virgjili i flet Dantes mjaft hapun e ndonjëherë edhe ashpër. Kjo nuk do thotë se Virgjili asht i tillë: me folë drejtpërdrejt asht gjithashtu shprehje e dashnisë.

atij të dëji - Shpeshherë, për shkaqe stilistike, Dante e vë veten në pozitë të vështirë e, në këtë rast, përballë madhësisë së Virgjilit, vetëparaqitet meskin, njeri i thjeshtë e aspak me trajta heroike, siç pritet nga një personazh protagonist. Ky mbiemën (në original: *magnanimo*) i përdorun për Virgjilin asht mjaft i randësishëm për botën morale danteske. Ai vetë e përshkruen kuptimin e kësj fjale në *Convivio* I (XI, v.18-20, f.26), tue vu përkundër saj, si edhe këtu, frikën, paburminë (v.45): "Ashtu si i madhnishmi përldvohet e shumëfishohet në zemër të vet, po në të njëjtën mënyrë frikakaku, por në të kundërt, hin e mpaket e duket edhe ma i vogël se ç'asht". I madhnishëm, shpirtmadh (që

48 e kjo për njerin asht shpeshherë pengim,
sa nga e përndershmijs nismë e ban me u kthye,
si hija kafshën tremb në t'zbehtë ndriçim.¹⁶
Por, që t'çlirohesh frikës pa arsye,
po t'them pse erdha, si dhe çfarë provova,
51 kur t'pashë, sa dhimbjes zemra më asht thye.¹⁷
Nder pezullorë kam qenë, ndërsa dëgjiova
t'më bzajë një grue plot hir e bukurí,
54 aq sa t'më urdhënonte i kërkova.¹⁸
I ndritnin sytë ma shumë se një yjsi;
filloi të m'thoshte shtrua fjalë ambëlsie,
57 me engjëllorin zâ të dlirtë kumti:¹⁹
'O mantovan, shpirtmadh fisnikërie,
që jotja famë n'atë shekul ende rron,
60 dhe sa t'ketë botë, s'do shuhet asnjëfjje,²⁰

ne e kemi sjellë me i dëjë për lavdim) asht ai që ka kurajo me marrë përsipër e me mbështetë ndërmarrje të mëdha. Një koncept i tillë i etikës aristoteliane, përfshihet nga Dante, ashtu si nga Tomas Akuini, në universin kristian, ku patjetër asht i randësishëm dinjteti dhe madhështia e njeriut, jo themelue në kreninë, por në Perëndinë.

Asht e njohun se, sidomos Kanga I, por edhe e dyta e Ferrit, janë mjaft të pasuna me kuptime simbolike e, si këshillon Sermonti, duhet pasë kujdes me alegoritë e Dantes. Nga njena anë, ky udhëtim i vështirë simbolizon për njeriun rrugëtimin e njohjes së pasojës së mëkatit, që asht një rrugë aq e naltë, por njëkohësisht e vështirë. Në hapat e parë të tij dhe në pragun e kësj kange, poeti na rrëfen se po gatitet me mbajtë barrët e këtij udhëtimit, qoftë fizike, qoftë shpirtnore. Nga ana tjetër, mendojmë se poeti aludon gjithashtu ndërmarrjen e thurjes së një poezie si kjo, çka vetëm menjshtra si Virgjili kanë mundë me ia dalë mbanë. Prandaj, për të, pika e referimit asht i madhnishmi Virgjil, i cili ka dhanë prova se ia ka dalë një vështirësi si kjo. Nga ky kand vështrimi, vetëm ai ka të drejtën morale për të qortue dhe dhanë zemër poetit të frikësue Dante. Siç e thamë ma nalt, vetëndosja e poetit në pozitë të vështirë përballë Virgjilit, për shkak të frikës, asht për qëllime stilistike, çka e ban ma të besueshme e reale, jo vetëm veprën, por edhe vetë poetin, që me dashje ka veshë rrobën e njeriut të zakonshëm, e personazhit shpeshherë antihero, tue u ba mjaft i afërt me lexuesin. Pikërisht për shkak të kësj, ai (lexuesi) gjendet gjithmonë në anë të tij, mënyrë kjo për të ba ma të lexueshme natyrën njerëzore, ma të ekspozueme për përmirësimin dobësitë e saj.

e madhja frikë - Në original: *viltade* - frikë, paburmi. Asht konsiderue një mëkat, meqenëse bahet pengesë që njeriu të përmbushë detyrat fisnike për të cilat ka thirrje, çka e konfirmojnë ma së miri vargjet e tercijnë në vazhdim.

16 kjo për njerin ... ndriçim - "Ashtu si kafsha kthen mbropa, trembë se hija në dritë të zbehtë i duket kërcënim e në të sheh çka aty nuk ka, kështu edhe njeriu shpeshherë dorëheq nga ajo çfarë ka marrë përsipër me ba, tue pasë frikë nga çfarë nuk duhet me pasë". (Buti, f.64)

17 frikës pa arsye - Frika e madhe (*viltade*), përmendë ma sipër në shëmbëlltyrë (v.46-48), asht deklarue e rrejshme. Kështu, edhe Dante duhet çliure nga kjo hije e rrejshme që i ndjell aq frikë, sa të heqë dorë nga një privilegj i tillë.

18 Ndër... - Me këtë tercijnë hapet një skenar i ri, ku shfaqet për herë të parë Beatrice. Drita që shpërthen me këto vargje, çka ban të mundun që një botë tjetër të shkëlqejë në brendësi të asaj ku drita nuk ka vend aspak, në rrafshin simbolik asht përgjigja e ankehte që Dante përjeton ma parë. Do të kishte mjaftue vetëm vargu 55 për të zhdukë çdo dyshim, frikë e ankth që ai përjeton. Në këto pak vargje, rigjiejmë Beatricën, por tashma në një tjetër dritë, në një tjetër dimension, kjo për faktin se i tjetërsue asht tashma poeti që për të thur vargje. Ndërsa në *Vita nova* gjejmë Beatricën si objektin e dashnisë së tij, mbas përvojave të shumta në poezi morale e doktrinale të *Convivio*, në *Komedi* Beatricja asht objekt përmirësimi, mbasi asaj poeti i ka veshë petkun e Teologjisë, për çka do të kemi rast të flasim ma poshtë.

pezullorë - Në strukturën që Dante ka mendue për Ferrin e tij, një vend të veçantë zënë njerëzit e shquem, si Virgjili. Mendojmë se Dante asht gjetë në zor e në vajt, gjithashtu edhe për vendin se ku do të rrinin këta njerëz, që veç Virgjilit, konsideronte Homerin, Ovidin, Lukanin, e të tjerë. Por duhet të trajtojmë një detaj shumë interesant në veprën e Dantes: këtu bindjet e tij si poet e filozof ndeshen me bindjet si i krishtenë. Si një njeri brumosë me besimin dhe teologjinë e krishtenë të kohës, Dante beson se Parajsja u hap si vend i shpirttrave të të drejtëve vetëm mbas vdekjes dhe ringjalljes së Krishtit. Deri në ardhjen e Krishtit, ai vend ishte e mybillun dhe të gjithë të vdekunit ishin në botën e nëndheshme, në Hades, edhe pse me një ndamje mes të drejtëve dhe mëkatarëve. Krishti zbriti në botën e të vdekurve dhe mori prej atje me vete në Parajsë patriarkët dhe hebrejtë që kishin vdeqë me besimin në Perëndinë dhe me shpresën e ardhjes së tij. Ndërsa tani, me vdekjen dhe ringjalljen e Krishtit, të gjithë ata që besojnë, pagëzohen dhe jetojnë si të krishtenë, kanë hymje të drejtpërdrejtë në Parajsë, në praninë e Perëndisë. Nga ky këndvështrim i krishtenë, të gjithë poetët e dijetarët e lashtë paganë, pavarësisht madhësisë së tynë njerëzore, tue mos njohë Perëndinë dhe tue mos besue në të, nuk mund të jenë në Parajsë.

Ndërsa si poet-filozof, tue qenë i mbrujtun me letërsinë klasike greko-romake, asht e pamundun të mos vlerësojë dhe vendosë në një pedestal, e ma të naltin, poetët apo dijetarët e tjerë, që do i ndeshim në Kangën IV. Prandaj thamë se Dante asht në vështirësi sepse, si poet, dëshiron t'i dërgojë në Parajsë, por si i krishtenë, duhet t'i dërgojë në Ferr. Kështu, në strukturën e Ferrit që ai ka ndërtue, ka gjetë një kompromis të shkëlqyeshëm nga pikëpamje poetike. Për këto personalitete të dijes e të kulturës, ka shfrytëzue një vend ku as nuk vucnejë (për ta nuk mund të ketë ndëshkim), as nuk janë të lumtun (tue mos njohë Krishtin, nuk mund të jenë në prani të Perëndisë). Nisë nga sa thamë, jeta e tynë këtu asht, si të thuesh, PEZULL, mes psherëvite. Për këtë vend, quejtë LIMB, do të flasim në kangët në vijim.

një grue - Në këtë varg na shfaqet për herë të parë Beatricja, që në poemë asht simbol i Teologjisë. Kjo shfaqje e parë e Beatricës, që asht pra fillimi i shpëtimit të Dantes, kur ky ende asht në mes të mëkateve, na vjen me gjithë menjshtrinë e simbolikë të *stilit të ri e të ambël* dantesk, përmes detajeve e hollesive që e bajnë atë (Beatrice-Teologjinë) të përsosun: e bekueme, e hijshme, syshkëlqye, me të folme të shtrume e të ngadalitë, me za thuejse engjëllor, plot dëlirësi.

19 ma shumë se një yjsi - Në original: *piu che la stella*. Shumica e komentuesve mendojnë se bahet fjalë për tanësinë e yjeve të Kupës Qiellore, edhe se fjala këtu (*stella*) asht në njëjtë. Por me përdorë njëjës in për shumës, ishte normë në poezinë e kohës.

të dlirtë kumti - Mendojmë se bahet fjalë, jo vetëm për përbajtjen e asaj çfarë po i thotë Beatrice, por edhe me mënyrën se si ajo shprehet. Tue fillue nga vargu ma nalt, jepen tre elemente që na bajnë me kuptue cilësinë e formës së kësj kumtie: *shtrua* (filloi të më thosh), *ambël* (fjalë ambëlsie) me *engjëllor za*. Kjo cilësi shprehjeje mendojmë se buron nga roli që Beatrice luen në *Komedi*, pra atë të Teologjisë e, në këtë këndvështrim, ajo e tillë asht: e sigurtë (shtrua) e pëlqyeshme (e ambël) dhe hyjnore (engjëllor).

20 O mantovan - Fjala e Beatricës fillon në mënyrën ma klasike të retorikës: tue shmangë emnin e personit që i asht drejtue,



111 Në botë kaq shpejt askush nuk ka vrapue të mirën t'kapë, a e keqja mos me e zanë, siç kam ngá vrap, kto fjalë me të dëgjue, ³⁷ për t'ardhë kaq poshtë nga ajo e nalta anë, me besë në fjalën që ti hirshëm endë,

114 që ty t'nderon e ata që ndi e kanë'. ³⁸ Porsa mbaroi çfarë kishte me kuvendë, ktheu sytë, që lotësh ndritnin edhe më, çka për këtu më bani n'çast me rendë. ³⁹ Dhe ja ku erdha, siç urdhnuje më ka: të hoqa bishës, që gjithkush e dron, e që nga mali shkurt s'të la me i ra. ⁴⁰ At'herë, pra, ç'ke? Përse, përse ndalon, pse n'zemër kaq shumë frikë t'ka ba strehim, 123 pse s'ndezesh flakë e pse kaq fort ngurron, ⁴¹

ja e papajtueshme dhe e përjetshme nga Perëndia. Asht për t'u kujtue vargu "I hidhët ish, sa vdekja më veç pak" (K.I, v.7), referue pyllit të mëkatit. Mungesa e pranisë së Perëndisë në jetën e njeriut, ndërsa ky kambëngul në një jetë mëkatore, asht një shije për përjetësinë, një idhësi e krahasueshme me të.

e ka sulmue - Figura e betejës mes njeriut dhe forcave të së keqes asht klasike në traditën e krishtenë: "Jini të përbajtur, rriini zgjuar; sepse kundërshitari juaj, djalli, sillet rreth e qark si një luan vrumbullues, duke kërkuar cilin mund të përpijë. Kundërshojeni, duke qëndruar të patundur në besim, sepse e dini se të njëjtat vuajtje po i heqin vëllezërit tuaj të shpërndarë nëpër botë" (1 Petrit 5:8-9). Siç asht në stilin e Dantes, në këtë varg na vjen kjo metaforë, përcjellë me një folje të vetme (*e ka sulmue*), e cila e ban, jo vetëm ma konkrete dhe të dukshme dramën e brendshme njerëzore, por njëkohësisht menjëherë të përceptueshme.

ku lumi me një det ka t'krahsumë - Varg mjaft i trajtue nga komentuesit. Të vjetrit mendojnë se Dante në mënyrë perifrazike tregon se ndodhen pranë hymjes së Ferrit, ku gjendet lumi Akeront, që nuk derdhet në det. Për këtë arsye deti nuk asht padroni, që pret t'i sjellë ujë ky lum-shërbëtor (në original: *ove l' mar non ha vanto*). Të tjerë mendojnë se bahet fjalë për lumin Jordan (Dante ka humbë rrugën në afërsi të Jeruzalemit). Edhe Jordani nuk derdhet në det, pra asht një lum i pavarun, që s'i jep detit llogari. Për sa na përket, mendojmë se nuk bahet fjalë për një lum të caktue, për faktin se asnjë lum i lundrueshëm nuk mund të krahasohet me detin për nga rrezikshmëria. Asht pikërisht kjo që duhet të kihet parasysh për të kuptue këtë varg: rrezikshmëria e lundrimit. Për të lashtët e deri në kohën e Komedisë e ma përtej, udhëtimet detare shpeshherë ishin fatale. Një numër mjaft i madh anijesh, që dilnin në det të hapun, nuk ktheheshin ma. Por një lum i rrëmbeshëm (që në fakt asht i palundrueshëm) asht i rrezikshëm e, për këtë arsye, deti nuk mund të krenohet para tij. Në këtë kandvështrim, tue i pa ujnate e tyne në garë për nga rrezikshmëria, lumi i rrëmbeshëm e i palundrueshëm asht i krahasueshëm me detin. Kështu, tue mos pasë një lum të rrëmbeshëm e të lundrueshëm (absurditet), komentuesit kanë ba përpjekje ta shpjegojnë këtë varg nën dritën e simbolikës: Dante ndodhet në lumin e rrëmbeshëm të mëkatit dhe mundësia asht që aty të mbytet. Ky lum asht ma shumë se një lum, që do të thohtë një tufë lumenjsh (shumë mëkate), një ardhje e skajshme ujnash që përpin gjithçka i ndodhet para. Në Kangën I (v.22-24), kur poeti sjell shembëlltyrën e atij që shpëton nga ujnate e rrezikshme, qëllimisht nuk ka përcaktue, mendojmë, se bahet fjalë për det apo lum të rrëmbeshëm, meqenëse njëlloj janë të rrezikshëm: "Si ai që lodhjes s'tepër frymë dihatë, / me t'dalë prej ujit, në breg të qëndrue, / kthen kryet me pa, rrezikun si tuj matë...". Interasant asht qëndrimi i V.Sermonit ndaj këtij vargu: "Varg i tmerrshëm dhe i urret, për ndriçimin e të cilit nuk hyn në punë asnjë lloj kandili...".

37 **kaq shpejt ... kam ngá vrap** - Shembëlltyra që sjell Beatrice për të tregue ngutin e saj, nuk ka të krahasue me atë njëri që ban gjithë çfarë asht e mundun me gjetë të mirën, apo me atë që instinktivisht i largohet rrezikut.

38 **në fjalën që ti hirshëm endë** - Virgjili flet në mënyrë të fisme, çka ia reflekton madhështinë, e ban të denjë për lavdërim (*O ti, i mbarë poetve dritë dhe nder / K.I, v.82*). Kjo cilësi e të folunës së Virgjilit që theksohet këtu, së bashku me atë shprehë ma sipër (*me fjalën tande të bukur / v.67*), pra përbajtia (fisnike, e ndershme) dhe forma e saj (bukuria) kanë ba që ai të jetë i përziejdhuni në Qiell për të shoqne Danten në këtë udhëtim përmes Ferrit e Purgatorit. Ndershmëria dhe bukuria e një të folune të tillë, që në fund të fundit për Danten asht të folunit poetik, lanë gjurmë në shpirtin njerëzor e aq, sa mund të bahet shtysë për njeriun me lanë rrugën e të keqes për të mirën. "Poeti rrefen se fuqia e fjalës mund të bajë të mundun një kthesë të pabesueshme" (Benvenuti, f.82).

ata që ndi e kanë - Kjo u referohet të gjithë atyne që janë ngritë shpirtnisht e intelektualisht, falë leximit të poezisë së Virgjilit, përfshi Danten.

39 **ktheu sytë** - Ktheu në një drejtim tjetër, u largue nga Virgjili. Ndërsa ka qenë tue folë me të, ajo e ka këqyrë në sy. Me të mbarue mesazhin e saj (*të delirtën kumti / v.57*), ka marrë më ikë në vendin ku zjarrmon me u kthye (v.84), pra ka heqë sytë prej tij. Por ka komentues të tjerë, si Bokaço, që mendojnë se ajo asht kthye për të fshehtë dhembshuninë e saj femnore, ndaj kavalierit prej të cilit adhurohet. Tue shkue, përmes lotëve, ajo ban pa dashje të dukshme anën e saj njerëzore.

që lotësh ndritnin edhe më - Sytë e Beatrices edhe ma parë na janë përshkrue mjaft të shndritshëm (*Ndritnin sytë e saj më se një ysi / v.55*). Ashtu siç hyn në skenë, ashtu del edhe prej saj: i vetmi detaj me anë të të cilit ajo na vizatohet fizikisht asht shkëlqimi e syve. Në një dritë të tillë ajo jeton, siç do të shihet në fund të Purgatorit dhe në gjithë Parajsën. Këta sy që kundrojnë Perëndinë, aspak nuk ngurojnë me lotue për fatin e keq të një njeriu.

40 **Dhe ja ku erdha** - Ky varg ban lidhje shkakore të takimit të Virgjilit me Danten prej takimit të Virgjilit me Beatricën, nga çfarë merr jetë fabula e Komedisë.

të hoqa bishës - Ulkoja-Lakmi, që e pat detyrue Danten të rikthejë në pyllin-mëkat.

mali - Mali, gjendet me të dalë nga pylli, mbasi kalon zallishten e shkretë; shpëtimi, mbasi ke heqë dorë nga mëkati.

që nga mali shkurt... - Ngjitja në kodër/mal, kalimi drejtpërdrejt nga mëkati në Hir e në bekim që vijnë me Hirin. Me ba këtë rrugë të shkurtë e të pamundimshme, ka tri pengesa (tri bishat). Ndaj asht e nevojshme me ba një rrugë ma të gjatë; me përfitue nga hiri menjëherë e shkurt, duhet të heqësh dorë përfundimisht nga mëkati, nga vesi. Sa ma e ashpër që të jetë kjo luftë, aq ma i gjatë bahet "udhëtimi pastrues". Me heqë dorë menjëherë nga mëkati, me i ra shkurt, asht teorike, por realisht e pamundun, prandaj për Danten asht i arsyeshëm ky rrugëtim i gjatë pendimi e pastrimi.

41 **At'herë, pra** - Mbasi i ka rrefye Dantes takimin me Beatricën dhe gratë e tjera të bekueme, Virgjili duket i kotë ngurrimi i matejshëm i tij, ndaj kërkon të vijë në përfundim që duket se shpejton me përsëritjen e vazhdueshme të pyetjeve.

Përse, përse... pse... pse... - Përsëritja e shpeshtë e *pse*-ve duket se shkul me rrajë hezitimin e Dantes. E bukuria dhe e fismja fjalë e Virgjilit, që ka rezultue siç pritej, ka hy në veprim me gjithë forcën e saj.

përderisa kto gra, me plot bekim, në Qiell për ty po kanë përkujdesi, dhe t'miat fjalë të sjellin t'tillë premtim?» ⁴² Ashtu si lulja, natën brymës ngri, mbyll fletët, por kur dielli ajrin vakë, drejtohet e me shend përballë i rri, ⁴³ kështu më ngjau me forcën time t'mpakë, kaq përtëri e turrrhëm zemrës m'rrodhi, sa që, kur fola, vetja m'ngjau përfllakë: ⁴⁴ «Oh, qoftë bekue ajo që n'ndihmë më ndodhi, dhe ti që n'çast iu binde dhe pa fjalë, me të vërtetat që n'gojë tande hodhi! ⁴⁵ Ma mbushe zemrën e më ndeze valë, aq sa do baj siç m'pate këshillue dhe, t'kthej n'dëshirë të parë, gja nuk më ndalë. ⁴⁶ Më prij, tashma n'një mendje më ke prù ti imzot, drejtuesi dhe mësuesi i mirë». 141 Kështu i thashë; mandej si n'udhë qe vù, i hyna shtegut t'naltë e të vështirë. ⁴⁷

Fjalor shpjegues i Këngës II

NË TEKST

- **kumti,-a** ^{II, v.57} "kumtim; lajm", formim nga fjala *kumt* me prap. -i, në hulli të gjuhës shqipe (khs. *dhëpërti, hjekësi, mjeshtëri, mrekullit* etj.); neologjizëm i vetë autorit.
- **kësisht** ^{II, v.21} "rrjedhorja e përmrit (*prej kësisht*)".
- **ngjatë (më u)** ^{II, v.80} "/më/ ngjatet; pres me padurim që të kryej një punë a një veprim".
- **pezullorë,-t** ^{II, v.52x} "të dënuarit në limb, që janë pezull, mes mosvuajtjes dhe moslumturisë; limbëtarët".
- **prù (me)** ^{II, v.139} "bie, sjell".
- **përfillë** ^{II, v.8} "ndf. fillë e përpë; fillim e mbarim; krejtësisht po sipas radhës", formim nga *fillë* me parshesën *për-*.
- **përkujdesi,-a** ^{II, v.125} "përkujdesje".
- **përndershëm (i)** ^{II, v.47} "i nderuar (në trajtën sipërore absolute); i denjë për nderim", formim me parshesën intensive *për-* dhe mbiemrit *ndershëm*.
- **Përtej** ^{II, v.13} "bota e përtejme; bota e vdekjes", neologjizëm i krijuar nga autori.
- **vujtuni,-a** ^{II, v.5} "tërësia e vuajtjeve", formim nga mbiemri i *vujtun* me prap. -i (khs. *pasuri, shkretë, varfëri* etj.).

NË SHËNIME

- **antihero,-i** ^{II, sh.15} "njeri i zakonshëm; që nuk shquhet për cilësi a vepra të jashtëzakonshme; e kundërta e heroit", kalk gjuhësor, i formuar pas gjedhes së italishtes.
- **aristotelian-e** ^{II, sh.30} "që i përket Aristotelit; që shkon pas hullisë së Aristotelit; që është e filozofisë së Aristotelit".
- **çarματοςës-e** ^{II, sh.4} "që të lë pa fjalë; që të zhvlerëson argumentat në një debat".
- **deuterokanonor** ^{II, sh.31} "Tërësia e librave të Dhjatës së Vjetër, që nuk u njihet natyra e shenjtë nga Kisha

pse s'ndezesh flakë - Me u ndezë flakë, asht ma shumë se me pasë guxim, çka vetëm vetëdija e një mbrojtje e tillë hyjnore mund të gjenerojë në njeriun.

42 **t'i tillë premtim** - Shpëtimin nga ulkoja; drejtimin për në rrugën e gjatë, por të sigurtë të pendimit.

43 **Si lulja... i rri** - Shembëlltyra, përfekte si në formë, ashtu edhe në përbajtie, mbyll kangën në të cilën rrefehet se si frika asht shndërrue në zjarr dëshirues. Përmes dy gjedjeve të personazhit Dante (ngurrimit në atë zallishte të shkretë dhe vendosmënisë tashma të zjarrtë për t'i hy atij udhëtimi plot rrezije / v.142), shfaqet figura e shkëlqyeshme e Beatrices, pors i rrezja mes dy gjedjeve të lules, në fillim e përkulun dhe e mbyllun, mandej e ngritun dhe e hapun ballas Diellit.

44 **kështu më ngjau...** - "Kështu shpirti i poetit kërrusej deri në tokë në natën e mëkatit prej ngricës së lakmisë, krejt i mbyllun tue e braktisë ofertën për të rrugëtue drejt virytit, por ngrohtësia e diellit, pra Hiri i Perëndisë, përmes fjalës bindëse të Virgjilit, e ripërtëria tue ia hapë zemrën për ta ba të gatshëm me rimirë atë rrugëtim" (Benvenuti, f.83).

kur fola - Me të rigjetë forcën e përtëri prej ligështimit shkaktue nga të ftohtët e territ i natës (frika), me të rigjetë shpresën që tashma e kishte humbë, Dantes i vjen trimnia dhe zani, jo vetëm me folë me Virgjilin, por me ba përpara sa ma parë drejt atij rrugëtimi të naltë e të vështirë.

kaq përtëri... përfllakë - Jo rastësisht bahet përsëritja e termave shqiptue ma parë nga Virgjili (v.123). Kjo për të ba të dukshëm plotësisht efektin e fjalëve të tij, që asht ndryshimi i plotë i gjedjes së Dantes.

45 **Qoftë e bekue... hodhi** - Të parat fjalë falënderuese të Dantes, tashma i përfurcuen në shpresë, i drejtohen së pari Beatrices, mandej Virgjilit.

të vërtetat - Fjalët e Beatrices drejtue Virgjilit, Dante i konsideron të vërteta, sepse janë shfaqje e dëshirës hyjnore dhe, meqenëse ajo përfaqëson Teologjinë, në fjalët e saj asht e vërteta.

46 **Ma mbushe zemrën...** - Këto dy vargje janë konfirmimi që Virgjili ka luejtë një rol të randësishëm në ndryshimin e qëndrimit të Dantes (krahaso v.67 dhe 113).

n'dëshirë të parë - Dëshirë që ka shfaqë në fund të Kangës I (v.130-136), me ndjekë Virgjilin në këtë udhëtim.

47 **ti imzot, drejtuesi dhe mësuesi i mirë** - "Asht e pamundun me ba rrugëtim nëse udhërrëfyesi dhe udhëitari nuk janë në një mendje: ti drejtuesi - për sa i përket rrugëtimit, sepse njeh rrugën, di ku shkon; ti imzot - mbi të gjithë, për sa u përket meritave, vlerave, zotësive; ti mësuesi i mirë - për sa i përket shembullit vetjak. Prandaj duhet një figurë e tillë për t'u ndjekë, sepse zgjidh problemin dhe fashit dyshimet" (Bokaço, III, v.139-142). Këta do të jenë emnat me të cilët tash e mbrapa Dante do të thërrasë Virgjilin në Komedi

si n'udhë qe vu... - Situa e këte pjesë të rrëfimit asht jashtëzakonisht e ngjashme me fundin e Kangës I (*si lëvizti, mbrapa i shkova mjeshtrit*), por tash, në ndryshim, Dante shkon i bindun për vështirësitë, gjithashtu i bindun se ndihma e Virgjilit asht Hiri që ai ka gjetë me përballue këto vështirësi.

t'naltë - Shih shënimin e vargut 12.

- Protestante, por që përkundrazi u njihet nga Kisha Katolike, Ortodokse dhe kisha të tjera të Lindjes", huazim nga italishtja *deuterocanonico* me të njëjtin kuptim.
- **diabolik-e** ^{II, sh.3} "djallëzor-e".
- **dorëheqë (me u)** ^{II, sh.16} "dorëhiqem; heq dorë (nga një punë etj.).
- **ekskluzivisht** ^{II, sh.7} "që është vetëm për dikë a për diçka të veçantë e të caktuar", formim nga *ekskluziv* me prap. -isht.
- **Gibelinë-t** ^{II, sh.9} "fraksion që, së bashku me Guelfët, kanë dominuar në skenën politike italice në shek. XII, deri në lindjen e Zotnimeve, në shek. XIII".
- **gjitkahshëm** ^{II, sh.3} "që është në të gjitha anët; që është i pranishëm gjithkund", kompozitë e formuar nga *gjith* + *kah/shëm*; neologjizëm, krijim i vetë autorit.
- **Guelfë-t** ^{II, sh.9} "fraksion që, së bashku me Gibelinët, kanë dominuar në skenën politike italice në shek. XII, deri në lindjen e Zotnimeve, në shek. XIII".
- **hamendësue (i)** ⁴ "që mirret me mend", komp. e formuar nga *ha* + *mend/ësue*/.
- **hirësi,-a** ^{II, sh.1} "dhëmbshuri; mëshirë".
- **impenjim,-i** ^{II, sh.21} "përqendrim; kujdes; kushtim; përkushtim; detyrim; zotim", formim me prap. -im-, përfundim i veprimt të foljes *impenjo/j*, kjo vetë nga ital. *impegnare* me të njëjtin kuptim.
- **italik-e** ^{II, sh.9} "që i takon Italisë; që është e Italisë".
- **komplimentue (me)** ^{II, sh.26} "përgëzoi, uroj", huazim nga ital. *complimentare* me të njëjtin kuptim.
- **kortezj,-a** ^{II, sh.27} "mirësjellje, njerëzi; mirësi", huazim nga italishtja *cortesja* me të njëjtin kuptim.
- **kortezial-e** ^{II, sh.26} "që sillet me kortezji; që është i njerëzishëm", formim nga *kortezj* me prap. -al/e/.
- **kryeorakull,-i** ^{II, sh.5} "kreu i orakujve në një tempull pagan (kur prej tyre ka shumë); ai që udhëheq orakujt e tjerë në një tempull pagan"; kompozitë e formuar nga emri *krye* + *orakull*; neologjizëm i autorit.
- **Limb-i** ^{II, sh.18} "treva ku janë vendosur pas vdekjes ata që gjatë gjalljes kanë qenë të papagëzuar".
- **mbarëqjellor** ^{II, sh.21} "që përfshin të gjithë qiellin; që ka të bëjë me qiellin mbarë", kompozitë e formuar nga *mbarë* + *qiellor*; neologjizëm i vetë autorit.
- **mirëmendue (me)** ^{II, sh.12} "mendoj mirë", kompozitë e ndërtuar nga *mirë* + *mendue*; neologjizëm (kalk gjuhësor) i krijuar nga vetë autori.
- **mirëpranuem (i)** ^{II, sh.35} "që është i pranuar nga të gjithë"; kompozitë e formuar nga *mirë* + *pranuem*, neologjizëm (kalk gjuhësor) i vetë autorit.
- **naltpërmendë (me)** ^{II, sh.4} "përmend edhe më parë (emër, fenomen) gjatë një shkrimi, mbledhjeje etj.". Kompozitë e formuar nga *nalt* + *përmend/ë*, krijim (neologjizëm) i vetë autorit.
- **pastërtisht** ^{II, sh.9} "në mënyrë të qartë; qartazi", formim nga *pastër/t* me prap. -isht.
- **patolerueshëm (i)** ^{II, sh.25} "që nuk tolerohet; që nuk lejohet kurrsesi", formim nga (*i*) *tolerueshëm* me parasht. *pa-*.
- **perifrazike** ^{II, sh.36} "që është si perifraza - kumtim jo i drejtpërdrejt, shprehur tërthorazi, me fjalë të tjera", formim nga *perifrazë* me prap. -ike, që ka hyrë në shqipe nga gjuhët moderne, kryesisht me përdorim libror.
- **poetikisht** ^{II, sh.1} "në mënyrë poetike", formuar nga *poetik* me prap. -isht.
- **psherëti,-a** ^{II, sh.18} "psherëtimë".
- **përceptueshëm (i)** ^{II, sh.36} "që mund të përceptohet; që mund të kapet".
- **rigjetë (me)** ^{II, sh.44} "me gjetë përsëri; me gjetë për së dyti", formim nga folja *me gjetë* me parshesën *ri-*.
- **shkujtes/e,-a** ^{II, sh.2} "antonimi i kujtesë", neologjizëm i autorit, formuar nga emri *kujtesë* me parshesën *sh-* (khs. *shbaj, shkallmoj, shkrij* etj.).
- **syshkëlqye** ^{II, sh.18} "që i shkëlqejnë sytë", kompozitë e formuar nga *sy* + *shkëlqyer*, neologjizëm i autorit.
- **temporal-e** ^{II, sh.9} "i përkohshëm, kalimtar"; këtu me kuptimin "që i përket kësaj bote", huazim nga ital. *temporale* me të njëjtin kuptim.
- **tradicionalisht** ^{II, sh.4} "në mënyrë tradicionale", formim nga *tradicional* me prap. -isht.
- **trikahshëm (i)** ^{II, sh.3} "që është në tre krahë", kompozitë e formuar nga numërori *tri* dhe *kah/shëm*, neologjizëm i krijuar nga vetë autori.
- **vetëparaqitë (me u)** ^{II, sh.15} "paraqitem vetë; prezantoj veten", kompozitë e formuar nga *vetë* + *paraqitë*, neologjizëm i krijuar nga vetë autori.
- **vetësfid/e,-a** ^{II, sh.3} "sfidimi i vetvetes; të sfiduarit e vetes tënde", kompozitë e formuar nga *vetë* + *sfidë*, neologjizëm i vetë autorit.
- **vetëvendosj/e,-a** ^{II, sh.15} "veprimi dhe rrjedhimi sipas foljes *vetëvendos* "vendos veten në një rrethanë".
- **vokacion,-i** ^{II, sh.3} "thirrje e brendshme; zë i brendshëm që të fton për të bërë një punë etj., prirje", huazim nga italishtja *vocazione* me të njëjtin kuptim.
- **vulgat/e,-a** ^{II, sh.10} "Bibla në gjuhën latine".

(Kanga III vijon në numrin e ardhshëm)

“SUKSESI” I TURISTIT-HULUMTUES AUSTRIAK NE NJE FOTOEKSPOZITE TE MANIPULUAR



Nga Gjon Bruçi

Në këta 27 vjet të turbullta të demokracisë kënetë, nëpër vendin tonë të quajtur “vendi i shqiponjave”, kanë hyrë e kanë dalë lloj-lloj pelegrinësh, syfetësh e kapuçinësh, të cilët kanë qenë tëpërkë me personazhet e “Emblemës së dikurshme” të shkrimtarit tonë I. Kadare. Kjo dyndje drejt nesh, nën petkun e turistit, studiuesit, hulumtuesit, fabrikuesit, mashtruesit, etj., ka ndodhur se, jo vetëm na mungon i zoti i konakut, por edhe “derën e kullës” e kemi shqyer me gjithë kanata. Është pikërisht kjo situatë, ndaj dhe turisti-hulumtues austriak Robert Pichler prej muajsh e vitesh, me aparat fotografik në krahu, ka mësy vatrën tona, duke na trokitur apo thirrur jo tek dera e kullës, siç është tradita, por tek “qenefët” prapa konakut.

Më konkretisht: Në datën 2 Shkurt 2018, shkrodranët patën rastin të “shijonin” hulumtimet e austriakut Robert Pichler, i cili “zbulimet” e tij 5-6 vjeçare, kryesisht në trevat e veriut të vendit tonë, i afishoi me anë të një fotoekspozite në Galerinë e Arteve të qytetit të lashtë. Ekspozita në fjalë emërtohej “Kthim në kohë. Shqipëria e viteve ‘90-të”. Të gjitha fotografitë e ekspozitës, të afishuara në stenda apo korniza të veçanta, realizuar midis viteve 1989 – 1996, pasqyronin anën më të errët e më të mjeruar të jetesës së shqiptarëve, kryesisht në trevat e Tropojës, Dukagjinit, Pukës e Mirditës, por edhe nga qoshe e skuta qytetesh, përfshi dhe Tiranën. Midis tyre kishte dhe foto të marra nga albumet e fotografëve shtetit të fundshekullit të 19-të, por të “mbartura” në vitet ‘90-të shekullit të 20-të. Për më tepër nuk mungonin dhe pamjet e stisura, marifeti i të cilave kuptohej që në vëzhgimin e parë. Për të argumentuar këtë të fundit, po komentoj një foto ku paraqitet një sofër e “shtruar” me meze e raki, në zonën e Fanit të Mirditës. Mbi suprinën e sofrës prej druri, të nxirë nga koha, pa asnjë lloj mbulese apo enë (pjatë, sahan apo kupë druri), ishin hedhur mezet: djathë, qepë dhe pak mëlçi berri, si dhe gotat e rakisë e cigaret e duhanit. Ne e dimë shumë mirë se në Mirditë, në Pukë, në Dukagjin e në disa krahina të tjera të thella e malore, gjer nga fundi i shekullit të 19-të, orenditë shtëpiake të të ushqyerit ishin luga dhe kupa e drurit. Por në vitet nëntëdhjetë të shekullit të njëzet, nuk mund të gjeje asnjë shtëpi, asnjë familje që nuk kishte sahanë prej bakri të kallajisur dhe të paktën disa pjata prej alumini, për të mos thënë që, në shumicën e shtëpive të malësisë kishte hyrë pjata e porcelanit, lugët e metalike e të kromuara të Gjirokastrës, gotat e qelqit dhe orendi të tjera të kohës. Që

kjo sofër e fotoekspozitës së austriakut ishte e manipuluar, e tregonin cigaret moderne (cigare paketas fabrike) dhe gotat e rakisë prej qelqi. Në kohën kur mirditori, pukiani apo dukagjinasi nuk kishte sahanë e pjata për të vendosur mezet, nuk kishte as gota qelqi, por e pinte rakinë me filxhanë kafeje, të cilat i siguronte me shumë mundim. Aq më pak bëhet fjalë që, në atë kohë të kishte mundësi të blinte cigare “moderne” fabrike, por e pinte duhanin me çibuk, ose duke e mbështjellë me gjethen e vetë duhanit.

Hulumtuesi e fotografi austriak Robert, në një periudhë prej 6 – 7 vitesh, nuk kishte lënë skutë qyteti e katundi pa fiksuar në celuloid. Por si për çudi, “kamera” i tij nuk kishte “kapur” qoftë dhe një sekuençë nga puna e shqiptarëve në transformimet epokale të vendit të tyre, që në vitin 1944 e kishin nga çdo pikëpamje në stadin e Mesjetës dhe pas gjysëm shekulli, në shumë fusha e patën rreshtuar me vendet e rajonit e më tej tij. Vini re: Autori midis të tjerave, kishte fotografuar një traget me njerëz në liqenin e Komanit. Trageti, vërtet ishte i vjetër, i palyer e, i pa mirëmbajtur, siç ishin shumë gjëra në vitet 1990-1996, kur vandalët e “demokracisë” kishin realizuar valën e parë të zjarrit, flakës e shkatërrimit mbi Shqipërinë. Por miku nga Austria i kishte të gjitha mundësitë që, krahas “Tragetit”, të pamirëmbajtur mbi liqenin e Komanit, të filmonte edhe digën e këtij Hidrocentali, ndër më të mëdhatë e më madhështoret në Ballkan e në Europë. Por jo, autori austriak Robert Pichler nuk e filmon digën. Megjithatë kur ka fotografuar Tragetin, bythën e kishte përmby digën në fjalë! Dhe të tilla aludime të drejta mund të bësh me dhjetra mbi fotoekspozitën e “mikut” nga Austria.

Pse ky cinizëm???

Duke përfutur nga fakti se austriaku në fjalë kuptonte mjaft mirë shqip dhe e fliste atë në masën mjaftueshëm, pas intervistës që ai i dha televizionit lokal, unë që u ndodha si vizitor i ekspozitës së tij, iu afrova dhe hyra në bisedë me të. E përshëndeta duke i dhënë dorën dhe, me qetësi e pyeta: “Gjatë turneut tuaj nëpër Shqipëri për disa muaj e disa vite, nuk gjetët asgjë të mirë e të bukur në jetën e malësorëve të veriut tonë, vetëm mjerim, varfëri, injorancë”? Dhe në vijim: “Si nuk ju rastisi të shikonit e të fotografonit edhe ndonjë aspekt nga puna në arë, në fabrikë, në hidrocentrale, në vatra e shtëpi kulture etj? Si nuk ju rastisi të shihnit e të fotografonit ndonjë shtëpi apo kullë të bukur e karakteristike, ndonjë kostum popullor të krahinave përkatëse, apo ndonjë aktivitet folklorik në logun e bjeshkëve etj., por vetëm ndërtesa gërmadhë, pazare të pista, orendi e rroba të sosura”?

Pyetjet e mia mbetën pa përgjigje, sepse autori austriak i fotoekspozitës nuk e

“zotëron” aq mirë shqipen, sa të kuptojë domethënien e pyetjeve të mia. Ai e ka hapur ekspozitën për të treguar se “në periudhën e socializmit, shqiptarët jetonin si njerëz të shpellave, ndërsa mbas vendosjes së Kapitalizmit, jeta e tyre është bërë përrallore”!!! Këtë “ndryshim”, ai ia thotë dhe televizionit lokal. Sepse ai ka ardhur në Shqipëri të bëjë një rrugë e dy punë: Të bëjë politikën e pronarit që e ka dërguar në këtë “mision” dhe, njëherësh të bëjë edhe biznes me “skup-qenefët” e shqiptarëve. Duke harruar se “qenefët” gjenden edhe në Austri, nëse do të provonte të fotografonte pas fasadës së sistemit që aplikon vendi i tij.

Për fat të keq, në të njëjtën linjë “suksesi”, ishte dhe Kuratorja e Ekspozitës, zonja E. Pula, e cila, krahas detyrës si këshilltare kulturore e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, bën dhe kuratoren e fotoekspozitës së austriakut Robert, me një entuziazëm të papërshtatshëm për suksesin e kësaj pune që, padrejtësisht dhe me cinizëm, poshtëron dinjitetin dhe identitetin e shqiptarëve të veriut të Shqipërisë.

Fotografi e “hulumtuesi” austriak Robert Pichler, të vetmen gjë pozitive në malësitë tona të veriut, kishte konstatuar mikpritjen e banorëve. Por për fat të keq, ai kishte abuzuar me këtë mikpritje. Së pari: Miku që është mik, kur të mësyn shtëpinë, nuk vjen nga “qenefi”, por nga dera e kullës. Së dyti, fotot e personazheve, ndonëse i ka marrë në mirëbesim, nuk besoj të ketë edhe lejen për t’i afishuar në Ekspozita publike. Por “mikut” në fjalë nuk i duhet “leja”, përdërisa ne e kemi shqyer portën dhe “kujdestarët” tanë lejojnë të hyjnë në vatrën tona lloj-lloj malukati, të cilët me “zbulimet” që realizojnë për “qenefët” tanë, bëjnë jo vetëm rolin e apologjetit të sistemit kapitalist në degradim, por edhe biznes personal, çka është sot dhe ideali i vetëm i shoqërisë kapitaliste të konsumit!

Nuk e di se sa i ingranuar është fotografi austriak, Robert Pichler, me lidhjet historike të Austrisë me Shqipërinë. Nëse do të kisha mundësi të ulesha “këmbëkryq” me mikun në fjalë, do t’i kujtoja se figura e personalitete të përmendura të vendit të tij, Austrisë, kanë ardhur në vendin e shqiponjave, dhe me dashamirësi kanë bërë hulumtime e kanë realizuar studime të vlefshme jo vetëm për popullin shqiptar, por edhe për vetë Europën. Do t’i kujtoja mikut në fjalë, Jon Georg fon Han (1811 -1869), i cili ka qenë themeluesi i studimeve për Shqipërinë. Do t’i flisja për Teodor Ipen (1861 -1935), një diplomat me veprimtari të dendur në Shqipëri, Konsull i përgjithshëm i Austrisë në vendin tonë në vitet 1900, studiues i etnografisë shqiptare. Do t’i tregoja për Alfred Rapaport Riter fon Arbengau (1868 – 1946), i konsideruar si një nga njohësit më të mirë të Lindjes, sidomos të Shqipërisë, zëvendës

Konsull në Shkodër në vitin 1895. Madje edhe mbiemri apo titulli “fon Arbengau” i këtij personaliteti lidhej me emrin latin “Arbanum”, me të cilin quhej rajoni i Shqipërisë së Epërme. Do t’i flisja për Baron Franc Nopçen, studiues në fushën e paleontologjisë, të gjeologjisë dhe të albanologjisë, dhe dorëshkrimet e tij pikante si “Shqipëria, fiset e malësisë së Veriut dhe e drejta e tyre zakonore”; “Besimi, doke e zakone”, “Fragmente të një studimi dialektologjik”, dhe “Udhëtime në Ballkan”. Të gjithë këta personalitete austriake, që kanë punuar apo hulumtuar në Shqipërinë e shekullit 19-të e fillim shekullit të 20-të, megjithatë gjetën një vend thellësisht mesjetar e të prapambetur, kurrë nuk i prekën vendatit me dokumente e filmime cinike, por si miq të vërtetë të shqiptarëve, shkruan me simpati e në mënyrë realiste për vendin e shqiponjave. Shkruan me simpati për gjërat më pozitive, duke anashkaluar në mjaft raste anën mjerrane të shqiptarëve, sepse këta personalitete e dinin fort mirë se prapambetja e madhe e Shqipërisë së shekujve të kaluar, kishte në themel, jo paafhtësinë e banorëve të saj, por “duart” e zeza të pushtuesve, midis tyre edhe të perandorisë Austrohungareze, që shqiptarët e quajnë edhe sot “Koha e Nemces”!

Më në fund, unë do të dëshiroja t’i kujtoj fotografit austriak Robert Pichler, se në këto vite që ai ka “hulumtuar” e fotografuar “qenefët” e shqiptarëve, në Shqipëri ndodhet edhe bashkatdhetarja e tij e nderuar Mariana Graff. Kjo Mariana Graf me bashkëshortin e saj, kanë rreth 25 vjet që e kanë kthyer Shqipërinë si një Atdhe të dytë, duke ia kushtuar veprimtarinë e tyre jo vetëm hulumtimet dhe evidentimet të traditave, dokeve e zakoneve të lashta e të reja të shqiptarëve, por edhe duke i ndihmuar ata në afrimin e plotë me popujt e Europës, ku shqiptarët pasardhës të drejtpërdrejtë të ilirëve, kanë qenë jo vetëm banorët e parë të kontinentit plak, por edhe promotorë të zhvillimit të tij.

Megjithatë, unë mbetem në merakun se revolta ime do të shkojë huq, përderisa në drejtim do të kemi politikanë kontraversë, të cilat kanë vënë në shitje e në biznes jo vetëm pamjet mjerane apo të manipuluar të zonave tona rurale, por kanë vënë në shitje tokën dhe detin e Atdheut tonë të shumvujtur, kanë vënë në shitje vetë dinjitetin dhe identitetin e shqiptarëve. Dhe shitja e dinjitetit dhe identitetit, shënon dhe fillimin e asimilimit si komb. Është ky fakt, që unë i jap një mijë herë të drejtë Enver Hoxhës, i cili, përveç të tjerave, si zot i vërtetë shtëpie, nuk lejonte që në konakun tonë të hynte e të dilte çfarëdo lloj kopuku e huligani, të cilët të mbuluar me pelerinën e turistit apo të pelegrinit, synonin të bënin punën e kapuçinit.

REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi Botimin:

GJERGJ LEQEJZA

Ma.di.sh PRODUCTION Kimay Produzione Giacche

